



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
NDËRMARRJA E PASTRIMIT

Nr. 16 prot.

Kamëz, më 13.3 2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. 16, datë 13.3.2025

Për

**“ MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE
URBANE, BASHKIA KAMËZ 2025-2030”**

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore"; ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" të ndryshuar, ligjit nr. 9537, datë 18.5.2006 "Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme" të ndryshuar, ligjit nr.10431 datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" të ndryshuar, VKM nr.687 datë 29.07.2015 "Për miratimin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve", VKM nr. 319, datë 31.5.2018 "Për Miratimin e Masave për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve", VKM nr. 232, datë 26.04.2018 Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 177, Datë 6.3.2012, "Për Ambalazhet dhe Mbetjet e Tyre", VKM nr. 652, datë 14.09.2016 "Për Rregullat dhe Kriteret për Menaxhimin e Mbetjeve nga Gomat e Përdorura", VKM nr.418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim", VKM nr.371 datë 11.06.2014 "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre", VKM nr.229 datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit", VKM nr.765, datë 07/11/2012 "Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura", VKM nr.175, datë 19/01/2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve", VKM nr.798, datë 29/09/2010 për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore", VKM nr.99, datë 18/02/2005 "Për miratimin e katalogut Shqipëtar të klasifikimit të mbetjeve", Urdhërit nr. 131, datë 27.01.2025 "Për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e planit të menaxhimit të integruar të mbetjeve".

Grupi i Punës i propozon Këshillit Bashkiak të miratojë Projekt Vendimin për:

M I R A T I M I N:

- **Miratimin e “Planit lokal të menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane, Bashkia Kamëz 2025-2030”, sipas lidhjes bashkëlidhur.**
- **Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ndërmarrja e Pastrimit Kamëz.**

Grupi i punës:

Rebeka Sulejmani
Zv. KRYETAR

Arben Laci
Drejtori i Ndërmarrjes së Pastrimit

Prel Gjonpalaj
Drejtori i Ndërmarrjes së Gjelbërimit, Parqeve dhe Rekreacionit

Vjollca Smaci
Drejtori i Financës dhe Kontabilitetit

Ramadan Hysa
Drejtori i Projekteve dhe Investimeve

Eduart Bodini
Drejtori i Taksave dhe Tarifave Vendore

Rivjana Hoxha
Drejtor i Burimeve Njerëzore

Eni Bistri
Drejtor i Cështjeve Ligjore dhe Burimeve Njerëzore

Erlend Babllëku
Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Mevlud Shehu
Përgjegjës i Sektorit Ligjor dhe Burimeve Njerëzore, Ndërmarrja e Pastrimit

Albjola Shahi
Përgjegjëse e Financës, Ndërmarrja e Pastrimit

Manushaqe Dragjoshi
Ing. Mjedisi

Endrijeta Gjini
Përgjegjëse, Ndërmarrja e Pastrimit

KRYETARI

Rakip SULI





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
NDËRMARRJA E PASTRIMIT**

Nr. ____ prot.

Kamëz, më __. __. 2025

RELACION PËR PROJEKT-VENDIMIN

Nr. ____, datë __. __. 2025

Për

**“ MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE
URBANE, BASHKIA KAMËZ 2025-2030”**

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore"; ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" të ndryshuar, ligjit nr. 9537, datë 18.5.2006 "Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme" të ndryshuar, ligjit nr.10431 datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" të ndryshuar, VKM nr.687 datë 29.07.2015 "Për miratimin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve", VKM nr. 319, datë 31.5.2018 "Për Miratimin e Masave për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve", VKM nr. 232, datë 26.04.2018 Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 177, Datë 6.3.2012, "Për Ambalazhet dhe Mbetjet e Tyre", VKM nr. 652, datë 14.09.2016 "Për Rregullat dhe Kriteret për Menaxhimin e Mbetjeve nga Gomat e Përdorura", VKM nr.418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim", VKM nr.371 datë 11.06.2014 "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre", VKM nr.229 datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit", VKM nr.765, datë 07/11/2012 "Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vjrrave të përdorura", VKM nr.175, datë 19/01/2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve", VKM nr.798, datë 29/09/2010 për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore", VKM nr.99, datë 18/02/2005 "Për miratimin e katalogut Shqipëtar të klasifikimit të mbetjeve", Urdhërit nr. 131, datë 27.01.2025 "Për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e planit të menaxhimit të integruar të mbetjeve", është hartuar plani lokal për menaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Kamëz.

Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane (PLMIMNU) është një dokument planifikimi strategjik, i cili mundëson zbatimin e politikave kombëtare të mbetjeve në nivel lokal, si një dokument/ udhëzues i rëndësishëm për menaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Kamëz.

Ky plan mundëson orientimin strategjik për të ardhmen dhe njëkohësisht krijon një qendrim të përbashkët midis aktorëve të ndryshëm për menaxhimin e mbetjeve në nivel lokal. PLMIMNU është më shumë i orientuar në veprime konkrete dhe të detajuara në lidhje me sistemin e grumbullimit, trajtimit, riciklimit, trajtimit final dhe impianteve respektive të trajtimit të mbetjeve.

Qëllimi i PLMIMNU konsiston në sfidën e re që ka bashkia për të ofruar shërbimin e menaxhimit të të mbetjeve në të gjithë territorin e saj, duke optimizuar koston e shërbimit kundrejt buxheteve të limituara që ka bashkia si dhe në hartimin e nevojave për investime kapitale për sektorin e menaxhimit të mbetjeve. Gjithashtu plani fokusohet edhe në përcaktimin e metodologjisë për zbatimin e sistemit të monitorimit, si dhe në ngritjen e kapaciteteve të brenda bashkisë për zbatimin e planit.

Më konkretisht, ky plan ka si qëllim të mundësojë dhe sigurojë si më poshtë:

- i. Përputhshmëri me Strategjinë Kombëtare të Mbetjeve (SKM) dhe objektivat e saj: duke kontribuar në zbatimin e politikave kombëtare dhe arritjen e objektivave kombëtare në fushën e mbetjeve;
- ii. Opsionet e manaxhimit të mbetjeve: për të mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve në përputhje me objektivat kombëtare. Planit identifikon fushat dhe teknologjitë e duhura për minimizimin dhe depozitimin (asgjësimin) final të mbetjeve;
- iii. Instrumente institucionale, organizative dhe rregullore: mundëson paraqitje të plotë të kuadrit institucional, organizativ dhe rregullator dhe rekomandon masat për përmirësimin e elementeve përbërës të tij, duke përfshirë ato që kontrollojnë mbetjet në të gjithë sistemin e manaxhimit për të siguruar përputhshmërinë me standardet e manaxhimit të mbetjeve;
- iv. Nevojat financiare për investime: duke përshkruar dhe argumentuar nevojat financiare dhe nevojën për investime për zbatimin e skemave të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve;
- v. Burime financiare për investime: duke krijuar një klimë të favorshme për sigurimin e fondeve qeveritare për mbetjet sikurse dhe fonde nga institucione ndërkombëtare.

Viti 1994 shënoi momentin kur autoriteteve lokale ju deleguan shërbimet e menaxhimit të mbetjeve dhe shërbime të tjera pastrimi, duke i bërë këto të fundit përgjegjëse për manaxhimin e tyre dhe njëkohësisht, duke u siguruar financimin nga qeverisja qendrore me anë të “granteve të pakushtëzuara”. Hartimi i planit vendor nga Njësitë e Qeverisje vendore është një detyrim ligjor i përcaktuar nga **Ligji i ri nr.10 463, datë 22.09.2011 “Për manaxhimin e integruar të mbetjeve”**, ku në nenin 12, pika 2 citohet: *Çdo njësi e qeverisjes vendore apo grup njësisish të qeverisjes vendore harton planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me planin kombëtar dhe planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe me kërkesat e nenit 10 të këtij ligji.*

Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve ka për qëllim të vërë në zbatim hierarkinë e menaxhimit të mbetjeve, e cila është një model ndërkombëtar dhe i njohur që synon trajtimin dhe menaxhimin më efikas të mbetjeve. Hierarkia përfshin renditjen e masave në një rend përparësie për të siguruar që mbetjet të menaxhohen në mënyrën më të qëndrueshme dhe më të shëndetshme për mjedisin dhe shëndetin publik.

Qëllimi universal i Planit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (PMIM) të Bashkisë Kamëz është të sigurojë një sistem të qëndrueshëm dhe efikas për menaxhimin e mbetjeve, që kontribuon në përmirësimin e kushteve të jetesës, ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit publik. Ky plan ka si objektiv integrimin e të gjitha proceseve të menaxhimit të mbetjeve, duke përfshirë mbledhjen, transportin, depozitimin, riciklimin dhe trajtimin e mbetjeve, në mënyrë që të sigurohet një sistem i qëndrueshëm, ekonomik dhe ekologjik për qytetarët e Kamëz.

Në përmbledhje, objektivat kryesore të PMIM janë:

1. **Përmirësimi i shërbimeve të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve:** Sigurimi i një shërbimi të rregullt dhe efikas për grumbullimin e mbetjeve nga qytetarët dhe transportimin e tyre në vendet e trajtimit, duke minimizuar vonesat dhe rritur cilësinë e shërbimit.
2. **Ndarja në burim dhe promovimi i riciklimit:** Inkurajimi i qytetarëve që të ndajnë mbetjet në burim (plastikë, letër, qelq, etj.), për të mundësuar riciklimin dhe uljen e sasive të mbetjeve që përfundojnë në landfill.
3. **Reduktimi i ndikimit mjedisor të mbetjeve:** Implementimi i zgjidhjeve që do të ndihmojnë në reduktimin e mbetjeve dhe minimizimin e ndikimit të tyre në mjedis, përfshirë mbrojtjen e burimeve natyrore dhe uljen e ndotjes.
4. **Edukimi dhe informimi i qytetarëve:** Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për rëndësinë e menaxhimit të duhur të mbetjeve dhe nxitja e bashkëpunimit të tyre për një mjedis më të pastër dhe të qëndrueshëm.
5. **Krijimi i mundësive për menaxhim efikas të mbetjeve:** Përdorimi i teknologjive të avancuara dhe metodave të trajtimit që përmirësojnë menaxhimin e mbetjeve dhe mundësojnë riciklimin e materialeve, uljen e mbetjeve që shkojnë në landfill dhe përmirësimin e efikasitetit të procesit.
6. **Sigurimi i një infrastrukture të përshtatshme:** Ndërtimi dhe përmirësimi i infrastrukturës për mbledhjen, grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve, duke siguruar që kjo infrastrukture të jetë e qëndrueshme dhe në përputhje me standardet mjedisore.

Ky plan është krijuar për të siguruar që Bashkia Kamëz të menaxhojë mbetjet në një mënyrë të përgjegjshme, duke ndihmuar në ruajtjen e mjedisit, shëndetit të qytetarëve dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në komunitet.

Synimi kryesor i Bashkisë Kamëz në këtë plan është përmbushja e standarteve të kërkuara për menaxhimin e mbetjeve, duke u siguruar që të respektohen parimet kryesore dhe kërkesat ligjore të planifikimit, që janë thelbësore për një menaxhim të qëndrueshëm dhe efikas. Ky synim përfshin disa aspekte të rëndësishme, të cilat janë:

1. **Përmbushja e standardeve dhe kërkesave ligjore:** Bashkia Kamëz do të punojë për të siguruar që menaxhimi i mbetjeve të jetë në përputhje me legjislacionin dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, duke garantuar një sistem të organizuar dhe të sigurt për mbledhjen, transportimin dhe trajtimin e mbetjeve.
2. **Mbuluarja e të gjithë territorit të aksesueshëm me shërbim:** Ky synim ka për qëllim zgjerimin e shërbimeve për mbledhjen e mbetjeve, për t'u siguruar që çdo qytetar të ketë akses në shërbimin e mbledhjes dhe menaxhimit të mbetjeve.
3. **Përmirësimi i situatës së financimit të shërbimit:** Për të mbështetur qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve, Bashkia Kamëz do të punojë për të përmirësuar financimin e këtyre shërbimeve, duke siguruar burime të mjaftueshme për realizimin e objektivave të planit dhe për mbështetje të infrastrukturës së nevojshme.
4. **Rritja e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes së komunitetit:** Një komponent i rëndësishëm është edukimi dhe angazhimi i qytetarëve për një menaxhim më të mirë të mbetjeve. Bashkia do të ndërmarrë fushata edukative dhe informuese për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe për t'i inkurajuar ata të kontribuojnë në ndarjen e mbetjeve, riciklimin dhe uljen e ndotjes. Pjesëmarrja aktive e komunitetit është thelbësore për suksesin e këtij plani.

Në përmbledhje, synimi i Bashkisë Kamëz është të krijojë një sistem të qëndrueshëm dhe efikas për menaxhimin e mbetjeve që plotëson kërkesat ligjore dhe standardet ndërkombëtare, duke siguruar një mjedis të pastër dhe shërbime cilësore për të gjithë qytetarët dhe vizitorët.

Për sa më sipër,

PROPOZJMË:

- **Miratimin e “Planit lokal të menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane, Bashkia Kamëz 2025-2030”, sipas lidhjes bashkëlidhur.**

DREJTORI

Arben LACI

Konc: Mevlud Shehu
Përgjegjës i Sektorit Ligjor dhe Burimeve Njerëzore



Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane

Bashkia Kamëz 2025-2030



SHKURTIMET

AKM	Agjensia Kombëtare
ARM	Agjensia Rajonale e Mjedisit
BE	Bashkimi European
ISHMPU	Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit Pyjeve dhe Ujrave
ISHSH	Inspektoriati Shtetëror i Shëndetësisë
MB	Mbetjet nga Bizneset
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MF	Mbetjet nga Familjet
MIE	Ministria e infrastrukturës dhe Energjisë
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
NJA	Njësi Administrative
NJQV	Njësi Qëndrore Vendore
OJF	Organizata Jo Fitim prurëse
PLMIMNU	Planin Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane
PKMM	Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve
PGM	Pikë Grumbullimi Mbetjesh
PPP	Partneritet Publik Privat
SKM	Strategjia Kombëtare e Mbetjeve
VKM	Vendim i Këshilit të Ministrave
ZAM	Zona e Administrimit të Mbetjeve

Plani Lokal i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane në Bashkinë Kamëz

Ky plan është përgatitur nga Bashkia Kamëz me mbështetjen e shoqatës “Bashki të Forta” të cilët kanë asistuar përgjatë të gjithë procesit të hartimit të këtij Plani.

TABELA PËRMBAJTJES

1 Contents

1	HYRJE	5
1.1	Nevoja për hartimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane	5
1.2	Politikat kombëtare dhe principet bazë të menaxhimit të mbetjeve.....	6
1.3	Aspektet institucionale të menaxhimit të mbetjeve	8
1.3.1	Organizimi në nivel qendror	8
1.3.2	Organizimi në nivel lokal	10
1.4	Informacion përmbledhës mbi legjislacionin	11
1.4.1	Kuadri Ligjor për Menaxhimin e Mbetjeve	12
1.5	Instrumentat për menaxhimin e integruar të mbetjeve në nivel vendor	13
2	PLANI KOMBËTAR I MENAXHIMIT TË MBETJEVE.....	15
2.1	Hierarkia e Menaxhimit të Mbetjeve	15
	<i>Hierarkia e menaxhimit të mbetjeve, sipas këtij Planit Kombëtar, përfshin këto faza:</i>	15
	<i>Pse është e rëndësishme kjo Hierarki?</i>	16
2.2	Ligji për Mbrojtjen Mjedisore	17
2.2.1	Politikat kombëtare dhe principet bazë të menaxhimit të mbetjeve	18
3	PËRSHKRIMI I SITUATËS SË PËRGJITHSHME	19
3.1	Profili i përgjithshëm.....	19
3.1.1	Përshkrimi i kushteve bazë të mjedisit.....	21
3.1.2	Topografia	22
3.1.3	Rrjeti hidrografik	24
3.1.4	Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta Urbane (PVMMNB)	25
3.2	Të dhënat mbi biznesin në Bashkinë Kamëz.....	29
3.3	Të dhënat mbi tarifën e pastrimit dhe të ardhurat.....	32
3.4	Të dhënat mbi të ardhurat e realizuara nga tarifa e pastrimit.....	37
3.4.1	Planifikimi i të ardhurave nga tarifa e pastrimit për vitet 2025-2029.....	38
3.4.2	Numri i taksapaguesve në Bashkinë Kamëz	38
3.4.3	Planifikimi i numrit të bizneseve në Bashkinë Kamëz përgjatë periudhës 2025-2029.....	40
3.5	Të dhëna mbi zhvillimin urbanistik të Bashkisë Kamëz.....	41
3.5.1	Rrjeti rrugor në Bashkinë Kamëz ku ofrohet shërbimi i pastrimit	42
4	ASPEKTET INSTITUCIONALE NË MENAXHIMIN E MBETJEVE URBANE	50
4.1	Organizimi në nivel qendror	51
4.2	Organizimi në nivel rajonal.....	51
4.3	Organizimi në nivel lokal (Bashkia Kamëz)	52
5	TRAJTIMI I MBETJEVE NË BASHKINË KAMËZ	53
5.1	Situata e pastrimit në vitin 2014:.....	53
5.2	Situata me pastrimin pas kalimit të shërbimit të koncesionari	53
5.3	Analizë e situatës aktuale të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në bashkinë Kamëz	54
5.3.1	Analiza e performancës së shërbimit të pastrimit për vitin 2024	55
5.3.2	Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve urbane në Bashkinë Kamëz.....	55
5.4	Depozitimi dhe Trajtimi i Mbetjeve në Bashkinë Kamëz.....	60
5.5	Reduktimi i Mbetjeve Urbane.....	60
5.6	Qëllimi dhe objektivat e PMIM Kamëz.....	62
6	ASPEKTET FINANCIARE NË MENAXHIMIN E MBETJEVE URBANE.....	65
6.1	Kosto e plotë e menaxhimit të mbetjeve urbane	65
6.2	Grumbullimi i Mbetjeve	65
6.2.1	Volumet e punimeve	65
6.2.2	Specifikime teknike dhe metodologjia.....	66
6.2.3	Frekuencat e grumbullimit.....	66

6.2.4	Plani i vendosjes së kontenerëve dhe grafikët e punimeve	66
6.3	Personeli	68
6.4	Llogaritja e kostos	68
6.5	Modeli i përlllogaritjes së kostove në menaxhimin e mbetjeve.....	72
6.6	Llogaritja e kostos së fshirjes dhe larjes së rrugëve:	98
6.6.1	Lista e rrugëve që lahen mekanikisht përgjatë 6 muajve.....	99
7	PLANIFIKIMI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE.....	100
7.1	Vizioni.....	100
7.2	Objektivat	100
7.2.1	Objektivat emergjente:.....	101
7.2.2	Objektiva afatgjatë:.....	101
7.2.3	Rryma e mbetjeve, objekti i planit.....	101
7.3	Shërbimet e menaxhimit të mbetjeve	102
7.4	Trajtimi përfundimtar i mbetjeve	104
7.5	Minimizimi i mbetjeve	105
8	KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL	107
8.1	Rregullorja vendore	107
8.2	Zbatimi dhe sanksionet.....	108
8.3	Ndërgjegjësimi publik.....	108
8.3.1	Model për hartimin e një fushatë informimi për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve dhe skemave për minimizimin e tyre.....	109
9	PLAN VEPRIMI	112
10	Monitorimi.....	119
10.1	Si kryhet monitorimi dhe vlerësimi.....	119

1 HYRJE

1.1 Nevoja për hartimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane¹

Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane (PLMIMNU) është një dokument planifikimi strategjik, i cili mundëson zbatimin e politikave kombëtare të mbetjeve në nivel lokal, si një dokument/ udhëzues i rëndësishëm për menaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Kamëz.

Ky plan mundëson orientimin strategjik për të ardhmen dhe njëkohësisht krijon një qendrim të përbashkët midis aktorëve të ndryshëm për menaxhimin e mbetjeve në nivel lokal. PLMIMNU është më shumë i orientuar në veprime konkrete dhe të detajuara në lidhje me sistemin e grumbullimit, trajtimit, riciklimit, trajtimit final dhe impianteve respektive të trajtimit të mbetjeve.

Qëllimi i PLMIMNU² konsiston në sfidën e re që ka bashkia për të ofruar shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në të gjithë territorin e saj, duke optimizuar koston e shërbimit kundrejt buxheteve të limituara që ka bashkia si dhe në hartimin e nevojave për investime kapitale për sektorin e menaxhimit të mbetjeve. Gjithashtu plani fokusohet edhe në përcaktimin e metodologjisë për zbatimin e sistemit të monitorimit, si dhe në ngritjen e kapaciteteve të brenda bashkisë për zbatimin e planit.

Më konkretisht, ky plan ka si qëllim të mundësojë dhe sigurojë si më poshtë:

- i. Përputhshmëri me Strategjinë Kombëtare të Mbetjeve (SKM) dhe objektivat e saj: duke kontribuar në zbatimin e politikave kombëtare dhe arritjen e objektivave kombëtare në fushën e mbetjeve;
- ii. Opsionet e menaxhimit të mbetjeve: për të mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve në përputhje me objektivat kombëtare. Planit identifikon fushat dhe teknologjitë e duhura për minimizimin dhe depozitimin (asgjësimin) final të mbetjeve;
- iii. Instrumente institucionale, organizative dhe rregullore: mundëson paraqitje të plotë të kuadrit institucional, organizativ dhe rregullator dhe rekomandon masat për përmirësimin e elementeve përbërës të tij, duke përfshirë ato që kontrollojnë mbetjet në të gjithë sistemin e menaxhimit për të siguruar përputhshmërinë me standardet e menaxhimit të mbetjeve;
- iv. Nevojat financiare për investime: duke përshkruar dhe argumentuar nevojat financiare dhe nevojën për investime për zbatimin e skemave të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve;

¹ Vendimi nr. 418, datë 27.5.2020 “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2025-2030”

² Vendimi Këshillit Kombëtar të Territorit nr.1, datë 13.01.2020 “Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta”

- v. Burime financiare për investime: duke krijuar një klimë të favorshme për sigurimin e fondeve qeveritare për mbetjet sikurse dhe fonde nga institucione ndërkombëtare.

Viti 1994 shënoi momentin kur autoriteteve lokale ju deleguan shërbimet e menaxhimit të mbetjeve dhe shërbime të tjera pastrimi, duke i bërë këto të fundit përgjegjëse për manaxhimin e tyre dhe njëkohësisht, duke u siguruar financimin nga qeverisja qendrore me anë të “granteve të pakushtëzuara”. Hartimi i planit vendor nga Njësitë e Qeverisjes vendore është një detyrim ligjor i përcaktuar nga **Ligji i ri nr.10 463, datë 22.09.2011 “Për manaxhimin e integruar të mbetjeve”**, ku në nenin 12, pika 2 citohet: *Çdo njësi e qeverisjes vendore apo grup njësisht të qeverisjes vendore harton planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me planin kombëtar dhe planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe me kërkesat e nenit 10 të këtij ligji.*³

1.2 Politikat kombëtare dhe principet bazë të menaxhimit të mbetjeve

Strategjia Kombëtare e Mbetjeve dhe Planit Kombëtar për Manaxhimin e Mbetjeve ka përcaktuar drejtimin e politikës së Qeverisë së Shqipërisë për manaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve deri në 2030, duke synuar minimizimin e impaktit të mbetjeve në mjedis në nivelin kombëtar dhe lokal si dhe përmirësimin e përdorimit eficient të burimeve në Shqipëri.

Kjo strategji është krijuar duke u mbështetur në angazhimin financiar të Qeverisë Shqiptare për të transformuar statusin e vendit në lidhje me reduktimin e mbetjeve, riciklimin, kompostimin apo përpunimin me përfitim energjie. Ajo ka vendosur objektiva sfidues dhe realiste njëkohësisht, të cilët synojnë mundësimin e ndryshimit rrënjësor të mënyrës së manaxhimit të mbetjeve në Shqipëri.

Strategjia kombëtare e mbetjeve paracakton katër shtylla kryesore me qëllim zbatimin e politikës dhe strategjisë së mbetjeve nëpërmjet Planit Kombëtar të Manaxhimit të Mbetjeve (PKMM). Këto shtylla politike janë thelbësore dhe shumë të rëndësishme për të garantuar qëndrueshmërinë dhe suksesin e të gjithë manaxhimit të mbetjeve në Shqipëri. Shtyllat politike janë si në vazhdim:

Planifikimi: Hapi i parë në zbatimin e procesit duhet të jetë zhvillimi i planeve për të çuar përpara axhendën e strategjisë dhe politikës së mbetjeve në lidhje me zbatimin;

Edukimi: Partnerët/bashkëpunëtorët kryesorë të sistemit duhet të edukohen në mënyrë që të përmbushin potencialin e tyre brenda sistemit dhe të lehtësojnë zbatimin e reformave;

Mbështetja financiare: Burimet njerëzore dhe vetë sistemi duhet të mbështeten financiarisht në mënyrën e duhur;


Kuadri ligjor: Sistemi kërkon një paketë rregulloresh. Për më tepër, për të siguruar hyrjen në Bashkimin Evropian, vendi do të duhet të bëjë përafrimin me legjislacionin përkatës të

³ Neni 10 i Ligji nr.10 463, datë 22.09.2011 “Për manaxhimin e integruar të mbetjeve”

Komitetit Evropian në fushën e mjedisit në vitet në vijim.

Direktivat e BE-së dhe dokumentat strategjik, rekomandojnë që të gjithë planet në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal duhet të bazohen në parimet e përgjithshme të paraqitur më poshtë:

- a) **Hierarkia e mbetjeve:** Hierarkia e mbetjeve përfaqëson një nga parimet kryesore udhëzuese në menaxhimin e mbetjeve në BE. Hierarkia përshkruan një set të metodave prioritare në menaxhimin e mbetjeve duke vendosur “parandalimin dhe ripërdorimin” në majë dhe depozitimin si alternativën më pak të favorshme.



Hierarkia e menaxhimit të mbetjeve⁴

- b) **Parimi reduktues:** Të sigurojë ruajtjen e burimeve natyrore, duke minimizuar sa më shumë të jetë e mundur gjenerimin e mbetjeve. Qëllimi kryesor në reduktimin e mbetjeve qëndron në domosdoshmërinë e ndërprerjes së lidhjes midis rritjes ekonomike dhe gjenerimit të tyre;
- c) **Parimi parandalues:** Të sigurojë reduktimin e impakteve nga mbetjet në shëndetin e njerëzve dhe të mjedisit, veçanërisht të reduktojë substancat e rrezikshme tek mbetjet;
- d) **Parimi i afërsisë dhe vetëmjaftueshmërisë:** Parimi i afërsisë dhe vetëmjaftueshmërisë kërkon që mbetjet të menaxhohen sa më afër vendit ku prodhohet. Politika e BE-së rekomandon që shtetet anëtare të merren vetë me mbetjet e tyre, duke shmangur eksportin në vende të tjera.
- e) **Parimi i përgjegjësisë së prodhuesit apo ndotësit:** Parimi “Ndotësi paguan” kërkon që prodhuesit e mbetjeve të mbulojnë koston e menaxhimit të mbetjeve që gjenerojnë. Kështu kostot mjedisore dhe kostoja e menaxhimit të mbetjeve në të gjitha proceset duhet

⁴ Dokumenti I Politikave Strategjike dhe Plani Kombëtar I Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2020-2035
PMMU Kamëz | 7

të reflektohen në çmimin e produktit si dhe në tarifat për ofrimin e shërbimit. Objektivi është ofrimi i një sistemi të drejtë dhe dekurajues për prodhimin pa kriter të mbetjeve.

Qeveria Shqiptare është e angazhuar në procesin e anëtarësimit të plotë në BE dhe për këtë qëllim Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është duke punuar drejt përafrimit dhe adoptimit të legjislacionit Shqiptar në përputhje me instrumentet legjislativë të BE-së. Progresi më i madh në fushën e mbetjeve është bërë në fushën e legjislacionit. Gjatë periudhës 2011 - 2016, legjislacioni Shqiptar për manaxhimin e mbetjeve është përmirësuar me ligje të reja, vendime dhe rregullore që reflektojnë direktivat e BE-së dhe detyrimet nga Konventa e Baselit.

1.3 Aspektete institucionale të menaxhimit të mbetjeve

1.3.1 Organizimi në nivel qendror ⁵

Aktorët kryesorë përgjegjës, në nivel kombëtar, në fushën e menaxhimit të mbetjeve janë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Bazuar në legjislacionin mjedisor në fuqi, **MTM** është institucioni i specializuar dhe përgjegjësi kryesor për hartimin e politikës së manaxhimit të mbetjeve; hartimin e legjislacionit, udhëzuesve dhe rregulloreve dhe zbatimin në nivel qendror me anë të dy autoriteteve të specializuara në varësi të saj: Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve (ISHMPU) dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Agjensive Rajonale të Mjedisit (ARM).

ISHMPU (në zbatim të Ligjit nr. 10431) është përgjegjës dhe ushtron aktivitetin për garantimin e mbrojtjes së mjedisit në nivel qendror dhe për kontrollin dhe zbatimin e legjislacionit mjedisor (ku përfshihen edhe mbetjet) në të gjithë vendin për të gjithë konsumatorët që gjenerojnë mbetje. Ai vendos penalitete për shkeljet administrative apo mund të pezullojë aktivitete që nuk janë në përputhje me legjislacionin mjedisor; informon rregullisht autoritetet lokale për gjendjen e mjedisit, aktet ligjore të miratuara dhe projektet e miratuara; kontrollon regjistrin e ndotësve (ku përfshihen dhe mbetjet), rregulloret teknike dhe teknologjitë. **ISHMPU** bashkëpunon me autoritete të tjera në nivel qendror, rajonal dhe lokal (si p.sh. **ARM**, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor **ISHSH**, **IKMT**-ja, Policinë Bashkiake etj.) për përmbushjen e detyrave të këtyre të fundit.

Agjensitë Rajonale të Mjedisit (në zbatim të Ligjit nr. 10431) janë autoritete të specializuara për monitorimin dhe mbrojtjen e mjedisit në nivel rajonal dhe, bashkë me **AKM**-më si njësi qendrore, përbëjnë rrjetin e agjencive mjedisore. Ato kanë për detyrë: (i) të realizojnë zbatimin e ligjeve mjedisore dhe atyre të manaxhimit të mbetjeve në nivel lokal dhe rajonal; (ii) të bashkëpunojnë me autoritetet lokale në zhvillimin e aksioneve, planeve, projekteve apo fushatave të sensibilizimit në nivel lokal; (iii) kanë përgjegjësi në miratimin e vendeve të grumbullimit të mbetjeve dhe japin, në bashkëpunim me autoritetet vendore,

⁵ Vendimi nr. 418, datë 27.5.2020 "Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2025-2030"

lejet mjedisore për impiantet lokale të mbetjeve apo aktivitete të tjera lokale.

MIE dhe më konkretisht Drejtoria e Politikave të Ujësjetës Kanalizimeve dhe Mbetjeve të Ngurta ka për detyrë formulimin dhe zbatimin e politikave kombëtare, normave dhe standardeve për shërbimet publike në fushën e mbetjeve urbane apo mbetjeve të tjera. MIE është autoriteti përgjegjës në nivel kombëtar për planifikimin, financimin, zbatimin dhe monitorimin e investimeve publike në fushën e menaxhimit të mbetjeve, rehabilitimit të fushave të venddepozitimeve, ngritjes së landfill-eve etj. Në zbatim të kuadrit ligjor, ajo duhet të përgatisë rregullore, teknika dhe metoda për të gjitha proceset e menaxhimit të mbetjeve si ndarja dhe grumbullimi i tyre, transporti dhe riciklimi, trajtimi dhe groposja etj. Gjithashtu, MTI është autoriteti kontraktues për koncesionin e aktiviteteve ekonomike nën përgjegjësinë e saj, duke përfshirë fushën e shërbimeve publike ku bën pjesë edhe menaxhimi i mbetjeve.

Këshilli Kombëtar i Territorit, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, miraton lejen e sheshit dhe lejen e ndërtimit për objektet (si rrjedhojë edhe për landfill-et) me një sipërfaqe më të madhe se 0.5 ha që ndërtohen jashtë kufijve administrative të sipërfaqeve të qytetit/fshatit/zonave të banuara.

Ministria e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, në bashkëpunim me MTM dhe në zbatim të ligjit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve harton rregullore për menaxhimin e mbetjeve në nivele të ndryshme të hierarkisë së menaxhimit të tyre dhe gjithashtu harton dhe zbaton rregulloren për mbetjet spitalore (miratuar Udhëzimi Nr. 6, dt. 30.11.2007);

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor është një autoritet në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, i cili ka për detyrë të kontrollojë dhe ndërmarrë veprime për të siguruar kushtet e nevojshme higjieno-sanitare për aktivitetet e ndryshme. Ai bashkëpunon me Inspektoratet Mjedisore dhe në raste të veçanta, edhe me inspektorate të tjera, sikurse edhe me autoritetet lokale për kryerjen e inspektimeve të aktiviteteve që lidhen me mbetjet. Aktiviteti i inspektoratit mbështetet në ligjin 7904 datë 8.3.1995 dhe ka për detyrë të vendosë gjopa për probleme që lidhen me mospastrimin e zonave urbane apo kur grumbullimi dhe depozitimi janë jo të përshtatshëm dhe bëhen të rrezikshëm për popullsinë. Përgjegjësia e inspektoratit shtrihet edhe në përcaktimin e vendgrumbullimit të mbetjeve.

Spitalet dhe gjithë prodhuesit e mbetjeve spitalore janë përgjegjës për administrimin e mbetjeve spitalore si dhe për projektimin e skemave të menaxhimit të mbetjeve të tyre, në përputhje me Planet Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Planet e Menaxhimit të Mbetjeve të Rrezikshme.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (në bashkëpunim me MTM) është përgjegjëse për hartimin e rregulloreve për:

- Mbetjet industriale
- Mbetjet minerale
- Rehabilitimin e venddepozitimeve në përputhje me specifikat.

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural (në bashkëpunim me MTM) është përgjegjëse për hartimin e rregulloreve për mbetjet bujqësore dhe shtazore.

Ministria e Financës (në bashkëpunim me MM) është përgjegjëse për hartimin e legjislacionit për paraqitjen e taksave të ndryshme mjedisore.

1.3.2 Organizimi në nivel lokal

Detyrat dhe përgjegjësitë: Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” dhe ligjin nr.10463 datë 22.09.2011 bashkitë janë përgjegjëse për të organizuar shërbimin e grumbullimit, transportit, trajtimit dhe depozitimit final të mbetjeve, duke i deleguar këto shërbime organeve lokale ose duke kontraktuar një kompani private të specializuar.

Bashkia përcakton:⁶

- Strukturat bashkiake për administrimin dhe monitorimin e shërbimeve të manaxhimit të mbetjeve si dhe inspektimin e territorit urban;
- Përcakton buxhetin e mjaftueshëm për mbulimin e shpenzimeve operative dhe të investimeve në fushën e mbetjeve; vendos tarifa për manaxhimin e mbetjeve urbane në territorin nën juridiksionin e saj dhe autorizon organizmat publikë apo privatë që t'i grumbullojnë ato;
- Harton dhe miraton rregullore lokale specifike territoriale për çdo metodë manaxhimi për mbetjet duke zbatuar rregulloret “tip” të miratuara nga MM, MTI dhe MSH;
- Harton planet e manaxhimit të mbetjeve urbane në nivel lokal apo rajonal në bashkëpunim me autoritetet rajonale dhe autoritetet e tjera lokale fqinje;
- Përcakton vendet dhe metodologjitë e përshtatshme për grumbullimin, trajtimin dhe depozitimin përfundimtar të mbetjeve në përputhje me kriteret mjedisore dhe planet e zhvillimit;
- Mbledh të dhëna dhe mban regjistrin lokal të mbetjeve si dhe kryen fushata sensibilizuese.

Në përputhje me legjislacionin mjedisor dhe për mbetjet, bashkitë kanë detyrimet si më poshtë:⁷

- Të kujdesen për higjienën publike kur kjo rrezikohet nga ndotja që shkaktohet prej mbetjeve të gjeneruara apo atyre të braktisura;
- Të zbatojnë projekte dhe investime për përmirësimin e gjendjes së mjedisit urban në lidhje me ndotjen e mbetjeve;
- Të monitorojnë dhe inspektojnë të gjitha proceset e manaxhimit të mbetjeve nga

⁶ Ligji nr.135/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

⁷ Ligji nr.10 463, datë 22.09.2011 “Për manaxhimin e integruar të mbetjeve”

grumbullimi deri në depozitimin përfundimtar në përputhje me standardet kombëtare mjedisore dhe rregulloret dhe manualët lokale;

- Të inspektojnë “zotëruesin e mbetjeve” për të konfirmuar zbatimin e rregullave dhe standardeve në nivel kombëtar dhe lokal dhe të vendosë sanksione në rast shkeljesh;
- Të bashkëpunojë me ARM për lëshimin e lejeve mjedisore për persona fizikë dhe juridikë që lidhen edhe me aktivitetin e tyre në raport me proceset e manaxhimit të mbetjeve;
- Të bashkëpunojë me ISHMPU, ARM si dhe inspektorate të tjerë për të ndërmarrë inspektime të mbetjeve dhe aktiviteteve që lidhen me to brenda territorit dhe juridiksionit lokal;
- Çdo njësi e qeverisjes vendore është autoritet kontraktues për koncesionet lidhur me aktivitetet ekonomike nën juridiksionin përkatës dhe, si rrjedhojë, edhe për koncesionin e projekteve mbi mbetjet (neni 5 i ligjit nr. 9663).

Këshilli Bashkiak: është autoriteti përfaqësues lokal me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për miratimin e buxhetit të mbetjeve dhe investimeve, miratimin e strukturave urbane për administrimin e mbetjeve, miratimin e nivelit të tarifave të mbetjeve dhe miratimin e dokumenteve rregullatore dhe strategjike (plane, plan-veprime) dhe është i përfshirë në procesin e dhënies së lejes për një vend për mbetjet e rrezikshme (Ligji 9537).⁸

Policia Bashkiake është përgjegjëse për të evidentuar dhe parandaluar ndotjen mjedisore dhe depozitimet e papërshtatshme të mbetjeve, dhe për të siguruar zbatimin e urdhërave, akteve lokale dhe vendimet në lidhje me manaxhimin e mbetjeve.⁹

IVMT, referuar legjislationit në fuqi, inspektoriat vendor i mbrojtjes së territorit ndër të tjera ka një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit nga faktorë të paligjshëm.

1.4 Informacion përmbledhës mbi legjislationin

Qeveria Shqiptare është e angazhuar në procesin e anëtarësimit të plotë në BE dhe për këtë qëllim Ministria e Mjedisit është duke punuar drejt përafrimit dhe adoptimit të legjislationit Shqiptar në përputhje me instrumentet legjislativë të BE.

Përmirësimi i menaxhimit të integruar të mbetjeve vazhdon të jetë një nga prioritetet kryesore të punës së Ministrisë së Mjedisit. Ndarja e mbetjeve në burim, rritja e nivelit të riciklimit, forcimi i kapaciteteve për menaxhimin e mbetjeve, asimilimi i plotë i hedhjes së mbetjeve në vendgrumbullime të pasigurta dhe asimilimi i plotë i djegies së mbetjeve, ndërtimi i landfillleve sipas standardeve të BE-së, sigurimi i lehtësive për mbetjet e rrezikshme, mjekësore ose ndërtimore, si dhe sigurimi i investimeve të reja për sa i përket ndarjes dhe riciklimit të mbetjeve, janë disa nga prioritetet kryesore në këtë fushë.

⁸ Ligji nr. 9537, datë 18.5.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”.

⁹ Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

LMIM adapton shumicën e direktivave, vendimet dhe rregulloret e BE-së, dhe parashikon prioritetet dhe hierarkinë për menaxhimin e mbetjeve që paraprihet nga: (1) parandalimi; (2) ripërdorim; (3) riciklimi; dhe (4) alternativa të tjera, si burim energjie; dhe (5) asgjësimin përfundimtar".

Ligji përcakton njëherazi dhe hierarkinë e autoriteteve në menaxhimin e mbetjeve, ndër të tjera pushteti vendor duhet të hartojë, miratojë dhe zbatojë PVMM.

Kuadri ligjor për menaxhimin e mbetjeve plotësohet me Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i cili në nenin 23, përcakton që mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake, është tërësisht një përgjegjësi funksionale dhe organizative e bashkisë.

Në tabelën më poshtë është bërë një përmbledhje e kuadrit ligjor Shqiptar në fushën e Manaxhimit të mbetjeve:

1.4.1 Kuadri Ligjor për Manaxhimin e Mbetjeve

Ligjet	Ligji nr. 10 463, datë 22.9. 2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve", amenduar me ligjin nr. 156, datë 10.10.2013
	Ligji nr. 156, datë 10.10.2013 Për Disa Ndryshime në Ligjin Nr.10463, Datë 22.9.2011, "Për Menaxhimin e Integruar Të Mbetjeve", të Ndryshuar
	Ligji nr. 9537, datë 18.5.2006 "Për Menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme"
	Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit"
VKM-të	VKM nr. 389, datë 27.6.2018 Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 452, Datë 11.7.2012, "Për Lendfillet E Mbetjeve"
	VKM nr. 319, datë 31.5.2018 "Për Miratimin e Masave për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve"
	VKM nr. 232, datë 26.04.2018 Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 177, Datë 6.3.2012, "Për Ambalazhet dhe Mbetjet e Tyre"
	VKM nr. 652, datë 14.09.2016 "Për Rregullat dhe Kriteret për Menaxhimin e Mbetjeve nga Gomat e Përdorura"
	VKM nr. 428, datë 08.06.2016 "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për hartën dixhitale venddeozitimeve të mbetjeve urbane"
	VKM nr. 687 datë 29.07.2015 "Për miratimin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve"
	VKM nr. 575 datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte"
	VKM nr. 387 datë 06.05.2015 "Për miratimin e rregullave për kontrollin e asgjësimit të PCB-ve, ç'ndotjen apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe/ose asgjësimin e mbetjeve të PCB-ve të përdorura "
	VKM nr.127 datë 11.02.2015 "Për kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujrave të ndotura"
	VKM nr.641, datë 01.10.2014 "Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme dhe mbetjeve inerte "

	VKM nr.608 datë 17.09.2014 "Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve BIO si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre"
	VKM nr.579 datë 03.09.2014 "Për një shtesë në vendimin nr.99, datë 18.02.2005 të Këshillit të Ministrave, për miratimin e Katalogut Shqipëtar të Klasifikimit të Mbetjeve"
	VKM nr.418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim"
	VKM nr.371 datë 11.06.2014 "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre"
	VKM nr.229 datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit"
	VKM nr.52, datë 05/02.2014 për disa ndryshime në Vendimin Nr.117, datë 13/02/2013 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret që përcaktojnë kur disa tipe të metalit scrap pushojnë së qeni mbetje"
	VKM nr.117, datë 13/02/2013 "Për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje"
	VKM nr.957, datë 19/12/2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike"
	VKM nr.866, datë 04/12/2012 "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre"
	VKM nr.765, datë 07/11/2012 "Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vjrrave të përdorura"
	VKM nr.705, datë 10/10/2012 "Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës"
	VKM nr.452, datë 11/07/2012 "Për Lendfill-et e mbetjeve"
	VKM nr.177, datë 06/03/2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre"
	VKM nr.178, datë 06/03/2012 "Për incinerimin e mbetjeve"
	VKM nr.175, datë 19/01/2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve"
	VKM nr.798, datë 29/09/2010 për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore"
	VKM nr.99, datë 18/02/2005 "Për miratimin e katalogut Shqipëtar të klasifikimit të mbetjeve"
Udhëzime	Udhëzim nr.1738, datë 12.03.2015 "Mbi kriteret e studim-projektimit për rehabilitimin e vend-depozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane, si dhe ndërtimin e Lendfilleve apo impianteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbane"

Tabela 1. Kuadri ligjor shqiptar për menaxhimin e mbetjeve

1.5 Instrumentat për menaxhimin e integruar të mbetjeve në nivel vendor

Bazuar në ligjin kuadër për menaxhimin e integruar të mbetjeve, i miratuar në vitin 2011 dhe i amenduar përsëri në vitin 2013, NJQV-të (bashkitë) duhet të hartojnë instrumentat vendorë për planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe kontrollin e shërbimit të mbetjeve, si:

Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane, si instrumenti

kryesorë i planifikimit për përcaktimin e vizionit dhe objektivat specifike, të mundshëm nga ana ekonomike dhe mjedisore, në lidhje me drejtimit që do të ndërmarrë bashkia në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Këto objektiva specifike duhet të reflektojnë orietimet e politikës kombëtare drejt menaxhimit të integruar të mbetjeve, të aktualizuara në gjendjen ekzistuese të bashkisë. Mbi bazën e objektivave specifike të dakordësuar në të gjitha nivelet vendimarrëse dhe me grupet e interesit, plani fillon dhe analizon skenarët e mundshëm të organizimit të shërbimit të shoqëruar me koston përkatëse dhe politikën fiskale që duhet të ndjekë bashkia në mbulimin e plotë të koston. Ai përfundon me një plan veprimi konkret të ndarë në afate kohore, brenda një 5 vjeçari, sipas përgjegjësive përkatëse të aktorëve të përfshirë në zbatimin e planit. Planit është një dokument planifikimi, i cili merr fuqi të plotë me miratimin nga Këshilli Bashkiak.

Rregulloret bashkiake për manaxhimin e mbetjeve për çdo rrymë specifike: është përgjegjësi e Bashkisë Kamëz të hartojë këto rregullore, e cila përcakton metodologjitë dhe rregullat për shërbimet e pastrimit të qytetit dhe manaxhimit të mbetjeve për të gjitha rrymat specifike të mbetjeve, brenda territorit administrativ të bashkisë, duke hartuar procedura për ankesat e banorëve, gjithashtu edhe kapitulli për aplikimin e sanksioneve në rast të mos zbatimit të rregullores nga aktorë të ndryshëm. Rregullorja duhet të miratohet nga Këshilli Bashkiak për të marrë fuqi të plotë ligjore.

Rregulloret për llogaritjen e koston dhe tarifave mbetjet: Në këtë kuadër, nisur edhe nga fakti që shumë shpejt këto metodologji do të miratohen edhe në nivel kombëtar, për t'u përdorur zyrtarisht nga të 61 bashkitë vendit, bashkia duhet të hartojë rregulloret përkatëse në lidhje me rregullat dhe procedurat për llogaritjen e koston vjetore të shërbimit dhe nivelit të tarifave për konsumatorë të ndryshëm që janë pjesë e skemës, sipas modeleve të dldp-së. Këto rregullore duhet të miratohen në Këshill Bashkiak.

Strategjia e informimit: një instrument tjetër mjaft i rëndësishëm për zbatimin e suksesshëm të planit të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane. Bashkia duhet të sigurojë angazhimin e plotë të komunitetit duke i informuar ata në lidhje me skemën e menaxhimit të mbetjeve që po zbaton në territorin e bashkisë dhe me politikën fiskale që ajo po aplikon. Bashkia duhet të hartojë një strategji informimi, që në hapat e parë të hartimit të planit, duke informuar komunitetin në lidhje me iniciativën që ajo ka ndërmarrë, objektivat e përcaktuar, skenarët që kërkon të aplikojë dhe politikën fiskale që bashkia kërkon të ndjekë. Kjo strategji duhet të përcaktojë edhe etapa të tjera që duhet të përsëritën vit pas viti, ku synimi kryesor duhet të jetë informimi i komunitetit në lidhje me proceset që zhvillon bashkia dhe marrja e opinionit të tyre në lidhje me performancën e shërbimit dhe sugjerimeve që ata mund të kenë. Zhvillimi i pyetësorëve të ndryshëm, apo i dëgjesave publike në periudha të ndryshme gjatë zbatimit të planit, janë disa nga elementet që strategjia e informimit duhet të parashikojë, për të matur opinionin qytetar, i cili duhet të reflektohet si në përmirësimin e shërbimit ashtu edhe të strategjisë së informimit.

2 PLANI KOMBËTAR I MENAXHIMIT TË MBETJEVE¹⁰

Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve ka për qëllim të vërë në zbatim hierarkinë e menaxhimit të mbetjeve, e cila është një model ndërkombëtar dhe i njohur që synon trajtimin dhe menaxhimin më efikas të mbetjeve. Hierarkia përfshin renditjen e masave në një rend përparësie për të siguruar që mbetjet të menaxhohen në mënyrën më të qëndrueshme dhe më të shëndetshme për mjedisin dhe shëndetin publik.

2.1 Hierarkia e Menaxhimit të Mbetjeve

Hierarkia e menaxhimit të mbetjeve, sipas këtij Plani Kombëtar, përfshin këto faza:

1. Parandalimi i Mbetjeve

Ky është hapi i parë dhe më i rëndësishëm në menaxhimin e mbetjeve, pasi parandalimi është gjithmonë më i mirë dhe më efikas se trajtimi i mbetjeve të krijuara. Masat për parandalimin e mbetjeve përfshijnë:

- ✓ Promovimin e konsumit të qëndrueshëm dhe reduktimin e mbetjeve gjatë procesit të prodhimit dhe konsumit.
- ✓ Inkurajimin e dizajnit të produkteve që janë të lehta për t'u ripërdorur, ricikluar dhe që shkaktojnë sa më pak mbetje.
- ✓ Edukimin e qytetarëve dhe bizneseve për praktikatat e qëndrueshme të konsumit dhe menaxhimit të mbetjeve.

2. Riciklimi dhe Përdorimi i Materialeve të Ricikluara

Ky është hapi i dytë në hierarkinë e menaxhimit të mbetjeve dhe ka për qëllim minimizimin e mbetjeve dhe maksimizimin e riciklimit të materialeve. Ky proces përfshin:

- ✓ Grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve të riciklueshme si plastika, letër, qelqi dhe metalet, duke siguruar që ato të riciklohen dhe të përdoren përsëri si lëndë për prodhimin e produkteve të reja.
- ✓ Krijimin e kushteve për zhvillimin e infrastrukturës së nevojshme për riciklim dhe përmirësimin e sistemeve të grumbullimit.

3. Përdorimi i Mbetjeve për Energjisë

¹⁰ Vendimi nr. 418, datë 27.5.2020 "Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2025-2030"

Kur riciklimi nuk është i mundur ose nuk është ekonomik, mbetjet mund të përdoren për prodhimin e energjisë. Ky hap përfshin:

- ✓ Përdorimin e mbetjeve për prodhimin e energjisë termike dhe elektrike, përmes proceseve si incenerimi, gasifikimi dhe anaerobia.
- ✓ Sigurimi që këto procese të realizohen në përputhje me standardet e mjedisit dhe të shëndetit publik, duke minimizuar ndotjen e ajrit dhe ndotjen tjetër mjedisore.

3. Përdorimi i Mbetjeve për Qëllime të Tjera (Kompostimi)

Mbetjet organike, si ato nga ushqimi dhe bimët, mund të përdoren për të krijuar kompost, i cili mund të përdoret për plehërimin e tokës. Ky hap ka për qëllim:

- ✓ Trajtimin e mbetjeve organike përmes procesit të kompostimit, duke ndihmuar në pasurimin e tokës dhe shmangur deponimin e tyre në landfille.
- ✓ Mbështetjen për krijimin e infrastrukturës për kompostimin e mbetjeve organike, duke përfshirë pajisje dhe qendra të grumbullimit.

4. Depozitimi në Deponi

Ky është hapi i fundit i hierarkisë dhe është gjithmonë opsioni më i fundit dhe më pak i dëshirueshëm. Depozitimi në deponi duhet të minimizohet dhe të zbatohet vetëm kur metodat e tjera nuk janë të mundshme. Ky hap përfshin:


- ✓ Trajtimin e mbetjeve që nuk mund të riciklohen, ripërdoren ose përdoren për prodhimin e energjisë, duke i depozituar ato në deponi në përputhje me rregullat e mjedisit dhe duke siguruar që ato të mos ndotin ujërat nënkatërrë dhe tokën.

Pse është e rëndësishme kjo Hierarki?

Kjo hierarki është e rëndësishme sepse:

- ✓ **Minimizon ndikimet negative mjedisore**, duke preferuar parandalimin dhe riciklimin mbi depozitimin e mbetjeve në landfille.
- ✓ **Ndihmon në ruajtjen e burimeve natyrore**, duke inkurajuar përdorimin e materialeve të ricikluara dhe duke zvogëluar kërkesën për burime të reja natyrore.
- ✓ **Rrit qëndrueshmërinë ekonomike dhe sociale**, duke krijuar mundësi për zhvillimin e industrive të riciklimit dhe trajtimit të mbetjeve dhe duke krijuar mundësi punësimi në sektorë të rinj.
- ✓ **Përputhshmëria me legjislacionin ndërkombëtar dhe të BE-së**, duke siguruar që Shqipëria të përmbushë kërkesat për menaxhimin e mbetjeve dhe të kontribuoni në zhvillimin e qëndrueshëm.

Në përfundim, kjo hierarki e menaxhimit të mbetjeve përbën një udhëzues të qartë për politikën dhe masat që duhet të merren për të siguruar një menaxhim të qëndrueshëm dhe të efektshëm të mbetjeve në Shqipëri, duke kontribuar në përmirësimin e mjedisit dhe shëndetit publik. Hierarkia e menaxhimit të mbetjeve është një mjet i rëndësishëm që synon të zvogëlojë ndikimin e mbetjeve në mjedis dhe të optimizojë përdorimin e burimeve natyrore. Duke ndjekur këtë hierarki, Shqipëria, ashtu si vendet e tjera, mund të përparojë në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm, mbrojtjes së mjedisit dhe përmirësimit të cilësisë së jetës për qytetarët e saj.



Parimi kryesor për menaxhimin e mbetjeve është hierarkia e mbetjeve që ka si qëllim renditjen e mundësive të menaxhimit të mbetjeve sipas qëllimit se çfarë është më e mirë për mjedisin dhe shëndetin e njeriut si dhe kalimin drejt ekonomisë qarkulluese. Përparësi i jepet parandalimit të mbetjeve duke synuar mbajtjen sa më gjatë si produkte. Në rastet kur produkti shndërrohet në mbetje, përparësia i jepet ripërdorimit, më pas riciklimit, më tej rikuperimit dhe në fund depozitimit.¹¹

2.2 Ligji për Mbrojtjen Mjedisore

Ligji për Mbrojtjen Mjedisore është guri i themelit i legjislacionit mjedisor në Shqipëri. Ai rregullon marrëdhënien ndërmjet qytetarëve dhe mjedisit; mbron komponentët mjedisorë; dhe proceset mjedisore. Aty sigurohen kushtet materiale për zhvillimin e qëndrueshëm, shfrytëzimin racional të mjedisit dhe kufizimin e ndotjes, etj (neni 1). Siç përcaktohet dhe në ligj, mbrojtja e mjedisit nga ndotja dhe dëmtimi është prioritet kombëtar dhe një detyrim për të gjitha autoritetet shtetërore, personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj të cilët kryejnë aktivitetin e tyre në

¹¹ Vendimi nr. 418, datë 27.5.2020 “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2025-2030”

Shqipëri (neni 2). Prandaj kërkohet që çdo aktivitet që ka një ndikim mbi mjedisin, duhet të liçenohet sipas rregulloreve që jepen në legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit.

2.2.1 Politikat kombëtare dhe principet bazë të menaxhimit të mbetjeve¹²

Qeveria Shqiptare miratoi me VKM nr. 418, datë 27.05.2020 “Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035”. Ky dokument strategjik do t’i mundësojë njësive të qeverisjes vendore një mjet mjaft frytdhënës për t’i udhëhequr ata në mënyrë të duhur për hartimin e planeve të tyre lokale për menaxhimin e integruar të mbeturinave, duke u bazuar në 4 qëllime strategjike për periudhën 2020-2035:

Qëllimi Strategjik 1	Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve, duke përmbushur parimet kryesore dhe kërkesat ligjore të planifikimit
Qëllimi Strategjik 2	Përmirësimi dhe harmonizimi i kuadrit ligjor të menaxhimit të mbetjeve
Qëllimi Strategjik 3	Financimi i qëndrueshëm i menaxhimit të mbetjeve
Qëllimi Strategjik 4	Burimet njerëzore, ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrja e popullatës në menaxhimin e mbetjeve

Ky dokument politik, në vetvete, siguron udhëzime strategjike për menaxhimin e mbetjeve, duke udhëhequr vendimmarrjen lokale drejt marrjes dhe zbatimit të një sistemi të qëndrueshëm të administrimit të mbetjeve. Dokumenti i Politikave Strategjike udhëzon njësitë e qeverisjes vendore për përcaktimin e objektivave të tyre specifike vendore, të matshëm, realistë, të arritshëm, bazuar në situatën e tyre ekzistuese dhe standardin minimal të miratuar për menaxhimin e mbetjeve.¹³

¹² Vendimi nr. 418, datë 27.5.2020 “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2025-2030”

¹³ Dokumenti I Politikave Strategjike dhe Planit Kombëtar I Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2020-2035

3 PËRSHKRIMI I SITUATËS SË PËRGJITHSHME

3.1 Profili i përgjithshëm¹⁴

Zona Gjeografike: Bashkia Kamëz kufizohet në veri, lindje dhe jug me bashkinë Tiranë, në veri-perëndim me bashkinë Krujë dhe në perëndim me bashkinë Vorë. Kamza përbëhet nga dy njësitë administrative, Kamza dhe Paskuqani.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2023 Bashkia Kamëz ka një popullsi prej 96000 banorësh, ndërsa sipas regjistrit civil numëron 150,101 banorë. Ajo ka një sipërfaqe prej 37.18 km².

Në bazë të censurit, densiteti i popullsisë është 2802 banorë për km² ndërsa sipas regjistrit civil, densiteti është 3379.02 banorë/km².

Të dhëna të tjera: Bashkia e Kamëz është bashkia me sipërfaqen më të vogël dhe me densitetin më të lartë në Shqipëri, duke e bërë atë praktikisht bashkinë më urbane të Shqipërisë pavarësisht se përfshin nominalisht edhe 14 vendbanime që zyrtarisht janë fshatra. Bashkia e re është ndërtuar gjatë 20 viteve të fundit ku rritja e popullsisë ka qenë në përmasa të jashtëzakonshme.

Kamza si qendër e banuar numëronte më pak se 5 mijë banorë të përqendruar rreth ndërmarrjes



¹⁴ Pasaporta e Bashkisë Kamëz , Porta Vendore.al
PMMU Kamëz | 19

bujqësore “Ylli i Kuq”, instituteve të teknologjisë bujqësore si dhe rreth minierës së qymyrit të Valiasit ndërsa popullsia u shtua me shpejtësi nga migrimi i brendshëm i popullsisë përgjatë 25 viteve të fundit. Kamza mori titullin e qytetit në vitin 1996 ndërsa Paskuqani, megjithëse zyrtarisht vijoi të klasifikohet si zonë rurale, u bë efektivisht zonë urbane me një densitet të lartë të ndërtesave dhe popullsisë.

Reforma territoriale e vitit 2015 krijoi bashkinë e re të Kamzës duke bashkuar në një administrim të vetëm një bashki – Kamzën dhe komunën e Paskuqanit, të cilat sot janë njësitë administrative të bashkisë sipas përcaktuimeve të ligjit Nr. 115/2014 “Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njërive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”.

Aktualisht Bashkia e Kamzës ka në përbërjen e saj 1 (një) qytet dhe 15 (pesëmbëdhjetë) fshatra. Për një qeverisje sa më të mirë e të fokusuar të qytetarët, bazuar edhe në numrin e lartë të popullsisë, Këshilli Bashkiak Kamëz e ka ndarë njësinë kamëz në tre njësi të reja, duke bërë që bashkia Kamëz t’i orientojë të gjitha politikat e saj në ndarjen territoriale me 4 njësi, ose më saktë,



- 1 Njesia Administrative Paskuqan
- 2 Lagjja Bathore krijuar me Vendim Nr.11 date 16.08.2019 “Per krijimin e lagjes se Bathores ne Bashkine Kamez”
- 3 Lagjja Nr.1 krijuar me Vendim Nr.16 date 27.01.2020 “Per krijimin e “Lagjes 1” ne Bashkine Kamez nga bashkimi i Kamza 3 (tre), Valias i Ri, Valias dhe Laknas”.
- 4 Lagjja Nr.2 krijuar me Vendim Nr.67 Date 25.06.2020 “Per Krijimin e “Lagjes 2” nga bashkimi i Kamez 1, Kamez 2, Kamez 4, Kamez 5, Zall Mner dhe Frutikulture ne Bashkine Kamez”

Sot, Bashkia Kamëz pozicionohet në pjesën qendrore të Shqipërisë, bën pjesë në qarkun e Tiranës dhe kufizohet në veri me bashkinë e Krujës, në veri- lindje, lindje, jug dhe jug-perëndim me bashkinë e Tiranës dhe në perëndim me bashkinë e Vorës. Territori, i ndodhur midis dy rrjedhave ujore që janë lumi i Tiranës dhe lumi i Tërkuzës, është kryesisht fushor, në pjesën lindore janë kodrat e Paskuqanit.

Kamza ka një pozicion të rëndësishëm nga pikëpamja e zhvillimit ekonomik pasi ndodhet në një nyje tepër strategjike midis kryeqytetit, aksit infrastrukturor që e lidh Tiranën me pjesën veriore të vendit, Kosovën dhe Malin e Zi, Portin e Durrësit. Prania e lidhjes hekurudhore dhe Aeroporti i Rinasit ndikojnë pozitivisht në pozicionin strategjik të bashkisë. Është bashkia me sipërfaqen më të vogël dhe me densitetin më të lartë në Shqipëri, duke e bërë atë praktikisht bashkinë më urbane në vend.

Kamza ka një sipërfaqe toke të punueshme prej 3927.63 hektarë, shifër kjo e papërfillshme në krahasim me popullsinë, ndërkohë që pjesa më e madhe e tokës bujqësore është e zënë nga banesat për shkak të ndërtimeve informale. Për shkak të vazhdimit të rritjes së shpejtë të popullsisë, që pasqyrohet në bum-in e ndërtimit dhe në sektorin e shërbimeve, Bashkisë Kamëz i duhet të përballet me probleme serioze mjedisore, në lidhje me menaxhimin e mbetjeve të ngurta, riciklimin, rehabilitimin e sipërfaqeve të gjelbra etj.

HARTA E TERRITORIT TË BASHKISË KAMËZ



3.1.1 Përshkrimi i kushteve bazë të mjedisit¹⁵

- Klima

Duke iu referuar ndarjes klimatike të Shqipërisë kjo zonë bën pjesë në nënzonën mesdhetare fushore qendrore dhe në nënzonën mesdhetare kodrinore qendrore (Vako, 2014). Sipas përcaktimit që bëhet në Hartën e Zonave Klimatike të Shqipërisë të përpiluar nga Instituti Hidrometeorologjik, i gjithë territori i bashkisë së

Kamzës ka një klimë tipike mesdhetare, me dimër të butë dhe verë të nxehtë. Karakteristikë për

¹⁵ Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Kamëz, ATELIER4
PMMU Kamëz | 21

stinën e dimrit janë shirat, të cilët në mjaft raste janë të dendura. Në shumicën e vendit një pjesë e reshjeve ndodh edhe gjatë vjeshtës së vonë dhe në prag të pranverës. Një tipar i dallueshëm i klimës së këtij territori është se aty përfshihen pothuajse të gjitha llojet e klimave të Shqipërisë, nga ajo mesdhetare fushore, deri tek ajo mesdhetare malore. Temperaturat mesatare vjetore luhaten nga 5,8 0 C në 15,10 C. Temperaturat maksimale absolute kanë arritur në 41,5 ndërsa ato minimale absolute në -10,50.

3.1.2 Topografia¹⁶

Territori i bashkisë Kamëz ka sipërfaqe 37.18 km² dhe ndodhet 7 km në jug- lindje të bashkisë së Tiranës. Kamza përbëhet nga dy njësi administrative, Kamza dhe Paskuqani. Bashkia e Kamzës është e vendosur në fushë aluvionale, ku lartësia mesatare është 90-110 metra (360 ft) mbi nivelin e detit. Terreni gradualisht ulet në drejtimin jug-perëndimor në 45 m mbi nivelin e detit, pranë aeroportit të Rinasit në pjesën veriore. Ajo ka formën e një lugine me shtrirje JL-VP. Lugina është e rrafshët, me pjerrësi të butë JL-VP me kuota absolute 110 m (Tiranë), 90 m (Rinas). Karakterizohet me reliev fushor dhe kodrinor me lartësi të ulët. Përshkohet nga rruga kombëtare që lidh kryeqytetin me veriun e vendit. Relievi përfaqësohet nga fusha e formuar nga lumenjtë Lana, Tirana dhe Terkuza. Janë fusha nga të sheshta deri me pjerrësi 30. Kuotat e tyre



¹⁶ Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Kamëz, ATELIER4
PMMU Kamëz | 22

janë të ndryshme, që nga 5 m mbi nivelin e detit e deri në 140 m (jugu i fushës së Tiranës). Këto fusha përshkohen nga një rrjet i dendur kanalesh kulluese e vaditëse, si dhe nga përrenje fushorë të cilët derdhen në shtretërit e lumenjve. Tokat në përgjithësi janë me ngjyrë kafe deri në gri të hapur dhe kanë shtrirje të kufizuar.

Liqeni i Paskuqanit: Topografia e zonës varion në reliev nga 90m deri në 120-130m. Në pikën më të ulët gjendet ujëmbledhësi i Paskuqanit që e njohim si liqeni i Paskuqanit. Përreth ujëmbledhësit topografia vjen duke u rritur sipas izoipseve që shihen në imazhin e mëposhtëm. Në zonat me reliev më të lartë ka hapsirë boshe me bar, e cila ka potencial si tokë bujqësore. Jashtë izoipsit 100m nis brezi i parë i ndërtimeve që rrethojnë parkun e Paskuqanit. Përgjatë topografisë në rënie kalojnë dy përronj të cilët mbledhin ujin e rreshjeve dhe e përcojnë tek ujëmbledhësi. Kjo metodë për mbledhjen e ujit është efektive pikërisht prej topografisë së zones. Terreni ka potencial të shfrytëzohet duke shkrirë mobilimet urbane në një mënyrë jo invazive për natyrën.



Në territorin e bashkisë së Kamzës, dalin në sipërfaqe shkëmbinj të moshave mesozoike dhe kenozoike. Këta shkëmbinj kanë veçoritë e tyre sipas zonës gjeotektonike së cilës i përkasin. Përshkrimi gjeologjik bazohet në Hartën Gjeologjike shk. 1:100,000, botimi i vitit 2014, si dhe në shumë studime të kryera nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar. Bazuar në hartë dhe zonën tektonike të bashkisë dallohen dy zona që përfaqësohen nga depozitime të miocenit të sipërm me dhera ranore, argjila, dhe depozitime të Pleistocen-Holocenit që paraqiten në formën e rërave, zhavore, alevrite. Nga pikepamja gjeologjike, territori i Bashkisë Kamëz është ndërtuar mbi formacione të Depresionit Pranë-Adriatik (D.P.A) dhe të Kuaternarit. Formacionet e Depresionit Pranë-Adriatik (D.P.A) janë depozitime mollasike dhe përgjithësisht shtrihen transgresivisht mbi

formacionet e poshtështruara të zonës Jonike dhe zonës së Krujës. Depozitimet mollasike ndërtojnë pjesën perëndimore e qendrore të territorit të qarkut të Tiranës. Depozitimet mollasike të Serravalianit dhe Miocenit të Sipërm të pandarë (N13) janë përshkruar më vete.

Bashkia e Kamzës nuk ka burime minerale me ndikim të konsiderueshëm në të ardhmen e zhvillimit të saj ekonomik, me përjashtim të minierës Valiasit, e cila përmban burime modeste qymyri. Prej më shumë se dy dekada kjo minierë qëndron e mbyllur dhe nuk është shfaqur ndonjë interes nga subjekte shtetërore apo private për rivënien e saj në shfrytëzim. Në planin strategjik të Bashkisë së Kamzës parashikohet alternativa që zona e minierës të vazhdojë të ketë karakter industrial, jo minerar, dhe të mund të shërbejë si klaster për aktivitete biznesi në fusha të caktuara (linja prodhimi, magazina, park logjistik etj).

3.1.3 Rrjeti hidrografik¹⁷

Territori Bashkië së Kamzës përshkrohet nga tre lumenj: lumi i Tiranës, Lanës dhe i Tërkuzës. Të tre këta rrjedhin poshtë nga ana jug-lindore në drejtimin veri-perëndimor përmes luginës së Tiranës. Lumi i Tiranës dhe lumi i Lanës përshkojnë pjesën qendrore të luginës së Tiranës, ndërsa lumi i Tërkuzës rrjedh poshtë në periferi të luginës, drejt veriperëndimit. Këta lumenj janë pjesë e pellgut ujëmbledhës të lumit Ishëm. Lumi-Ishëm përshkon gjithë luginën me degët e tij: Lana, Tirana, Tërkuza të cilët në fshatin Larushk formojnë Lumin-Gjola. Më tej, Lumi Zeza së bashku me Lumin Gjola në fshatin Bilaj formojnë Lumin Ishëm. Delta e Lumit Ishëm ndodhet në Kepin e Rodonit. Prurja mesatare vjetore e Ishmit është 20.9 m³/sek me modul mesatar të rrjedhies 31.01 l/sek/km² ndërsa prurja maksimale është 1980 m³/sek. Në sipërfaqen më të madhe shtresa ujëmbajtëse mbulohet nga një shtresë argjilore. Mbulesa suargjilore mbi shtresën e zhavorreve fillon nga 0 deri disa metra m në afërsi të shtratit të lumenjve (Lana, Tirana, Tërkuza, Zeza, Droja) deri në 40-50 m. (Vako, 2014) Prurjet e këtyre lumenjve kanë luhatje të mëdha; lumi i Tiranës varion nga 0.3 - 300 m³/sek; Lumi i Lanës nga 0.1-30 m³ / Sec dhe Lumi i Tërkuzës nga 0.5-400 m³ / Sek ose më shumë. Në pjesën e sipërme të lumit të Tërkuzës është ndërtuar një digë dhe prej këtij ujëmbledhësi furnizohet kryesisht qyteti i Tiranës. Regjimi i natyrshëm i lumit të Tërkuzës aktualisht ka pësuar ndryshime rrënjësore, për shkak të ndërhyrjeve me qëllim marrjen e inerteve. Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore mund të përdoret si ujë i pijshëm për vlerat e tyre natyrore, por në të njëjtën kohë ato janë të kërcënuara nga ndotja urbane. Mbetet konstant kërcënimi nga përmytjet, në momente prurësh të mëdha. Në vitet e fundit ka patur dëme të konsiderueshme në objektet e banimit për shkak të përmytjeve. Përveç investimeve me natyrë parandaluese, nevojitet edhe koordinimi i ngushtë i punës me Bashkinë e Tiranës. Liqeni i Paskuqanit është një prej resurseve më të rëndësishme ujore të Bashkisë së Kamzës. Ai zë një sipërfaqje prej 170 ha dhe aktualisht zona përreth liqenit është zënë nga banesa informale të ndërtuara pas viteve '90, por numri i tyre është i pakët. Ky liqen mund të marrë një rëndësi të veçantë, pasi në drejtim të tij shkon zgjatimi i bulevardit qendror të kryeqytetit dhe egziston një projekt mjaft ambicioz për ta shndërruar zonën përreth liqenit në një park të madh, të gjelbër me karakter pushues e argëtues. (Plani Operacional i Zhvillimit Vendor Bashkia Kamëz, 2016) Sipërfaqja e ujëmbledhësit është zvogluar si rezultat i rënies së sasisë së prurjeve, ndërtimet

¹⁷ Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Kamëz, ATELIER4
PMMU Kamëz | 24

informale si dhe humbjes së funksionalitetit për të cilin është ndërtuar. Pasqyra ujore është variable dhe është në korelacion me sasinë e rreshjeve, dhe mos funksionit të kanalit të furnizimit të tij me ujë. Aktualisht, ky rezervuar është kthyer në një pellg ujëmbledhës ku pothuajse gjatë gjithë vitit qëndron në kuotën “niveli i vëllimit të vdekur”. E gjithë sipërfaqja e tokës bujqësore prej 3000 ha (kapaciteti i projektuar i aftësisë ujitëse), që ky rezervuar fuste nën regjimin ujqor është transformuar në sipërfaqe/territore të urbanizuara.

3.1.4 Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta Urbane (PVMMNB)

Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta Urbane (PVMMNB) është një dokument planifikimi strategjik, i cili mundëson zbatimin e politikave kombëtare të mbetjeve në nivel Vendor, si një dokument/ udhëzues i rëndësishëm për menaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Kamëz

Ky plan mundëson orientimin strategjik për të ardhmen dhe njëkohësisht krijon një qëndrim të përbashkët midis aktorëve të ndryshëm për menaxhimin e mbetjeve në nivel Vendor. PVMMNU është më shumë i orientuar në veprime konkrete dhe të detajuara në lidhje me sistemin e grumbullimit, trajtimit, reduktimit, dhe impiantet respektive të trajtimit të mbetjeve.

Gjithashtu, nga shqyrtimi i gjendjes aktuale të shërbimit të largimit të mbetjeve të ngurta urbane, do të rishikohen dhe do të përcaktohen qëllime dhe objektiva për një shërbim cilësor duke realizuar sistemin e matjes së performancës, duke hartuar një plan të detajuar teknik dhe financiar, si dhe në fund duke monitoruar dhe bërë vlerësimin e situatës sipas protokollit të Monitorimit dhe Vlerësimit

Ky plan përcakton mënyrën sipas së cilës do të ushtrohet dhe shtrihet funksioni i menaxhimit të mbetjeve. PMIM ofron zgjidhje lokale gjerësisht të pranuar dhe një kuadër të miratuar pune, sipas të cilit mund të merren vendime lidhur me infrastrukturën që nevojitet për të përmbushur zbatimin e praktikave më të mira mjedisore. Plani nxit një pjesëmarrje më të mirë të gjitha palëve dhe paraqet një këndvështrim strategjik të menaxhimit të mbetjeve, duke e vënë theksin në zgjerimin e zonës së shërbimit, në sasinë në rritje të mbetjeve dhe lehtësirat e nevojshme për menaxhimin e mbetjeve.

Gjithashtu, plani përfshin:

- Vlerësim të gjendjes aktuale të shërbimit të largimit të mbetjeve të ngurtaurbane;
- Qëllimin dhe objektivat për shërbim cilësor të menaxhimit të mbetjeve;
- Sistemi i matjes së performancës;
- Një plan të detajuar teknik dhe financiar për menaxhimin e integruar të mbetjeve; dhe, Protokollin e monitorimit dhe vlerësimit (M&V)

Plani ka për subjekt menaxhinin e Mbetjeve të Ngurta Bashkia (MNB) përfshirë ato shtëpiake dhe të ngashme që gjenerohen nga subjekte të tjera të cilat mblidhen nga bashkia dhe/ose në emer të bashkisë, përfshirë edhe ato mbetje të cilat mund të mblidhen nga subjekte private për qëllimine rikuperimit.

Plani i Menaxhimit të Mbetjeve do të mbulojë hapesirën kohore 2025 - 2030.



Figura 1. Parku i Liqenit të Paskuqanit

1.2 Demografia e Bashkisë Kamëz¹⁸

Referuar të dhënave që administrohen pranë Zyrës së Gjendjes Civile, Bashkia Kamëz si dhe të dhënave që administrohen pranë Zyrës së Gjendjes Civile Paskuqan, Njësia Administrative Paskuqan, të dhënat mbi ndryshimin e popullsisë janë si më poshtë, vijon:


A. Njësia Administrative Paskuqan

Viti	Numri i popullsisë sipas Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile
2020	47972

¹⁸ Sipas të dhënave që administrohen pranë Zyrës së Gjendjes Civile Kamëz dhe Paskuqan
PMMU Kamëz | 26

2021	49126
2022	50506
2023	51185
2024	51615

Tabela 2. Të dhënat mbi popullsinë në Njësinë Administrative Paskuqan.




Grafiku 1. Rritja e popullsisë sipas viteve në Njësinë Paskuqan

B. Bashkia Kamëz (Kamëz, Bathore, Laknas-Valias)

Viti	Numri i popullsisë sipas Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile
2020	92647
2021	93638
2022	95119

2023	96911
2024	98486

Tabela 3. Të dhënat mbi popullsinë në Bashkinë Kamëz.



Grafiku 2. Rritja e popullsisë sipas viteve në Njësinë Kamëz


Sipas të dhënave që administrohen, përgjat viteve 2020-2024, Bashkia Kamëz ka patur një rritje të popullsisë me 9482 (nëntë mijë e katërqind e tetëdhjetë e dy). Aktualisht popullsia e Bashkisë Kamëz është 150 101 banorë. Referuar të dhënave të censusit të vitit 2023, Bashkia Kamëz përbëhej nga 96000 banorë.¹⁹

Në Bashkinë Kamëz ka një popullsi prej 150 101 banorë (sipas Regjistrit të Gjendjes Civile Bashkia Kamez). Referuar Vendimit nr. 538, datë 22.09.2021 “Për disa shtesa në vendimin nr.687, datë 29.7.2015, Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”, Bashkitë duhet të përdorin numrin e popullsisë për llogaritjet e sasisë së mbetjeve që gjenerojnë, sipas formulës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duke shmangur mospërputhjet që vijnë të dhënat e popullsisë sipas Regjistrit të Gjendjes Civile dhe Popullsisë së INSTAT-it (2023).

Popullsia= Popullsia (Census) + (Popullsia Regjistri Gjendjes Civile-Popullsia Censusi 2023) *

¹⁹ Të dhënat që referon në faqen zyrtare ISNTAT
PMMU Kamëz | 28

0.30²⁰



Grafiku 1. Popullsia në total përgjat viteve në Bashkinë Kamëz.

3.2 Të dhënat mbi biznesin në Bashkinë Kamëz²¹

Në Bashkinë Kamëz, sipas të dhënave që administrohen pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, numërohen rreth 4033 biznese, ku 849 biznese kategorizohen si Biznesi i Madh, dhe 3184 biznese kategorizohen si biznes i vogël. Të gjitha bizneseve dhe institucioneve iu është ofruar shërbimi i pastrimit dhe largimit të mbetjeve.

Të dhëna sipas kategorive të bizneseve:

Nr.	Aktiviteti
Kategoria e Biznesit	

²⁰ Vendimi nr. 538, datë 22.09.2021 “Për disa shtesa në vendimin nr.687, datë 29.7.2015, Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”,

²¹ Sipas të dhënave që administrohen pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Kamëz
PMMU Kamëz | 29

I Shitje me shumicë dhe pakicë		Biznes I vogël	Biznesi I Madh	Totali
	Mish, peshk	28	4	32
	Bulmet,fruta, perime, ushqimore	211	39	250
	Artikujt industrialë (veshje, parfumeri, argjendari, etj të ngjashme me to).	357	89	446
	Bar kafe	314	6	320
	Restorant, fast food etj të ngjashme me to	88	2	90
	Pub, diskoteka etj të ngjashme	4	1	5
	Kafe internet, lojëra fati, qendra interneti	14	7	21
	Materiale të ngurta, inerte, çimento,hekur, dru zjarri, lëndë drusore, import-eksport etj.	88	169	257
	Tregti materiale të imta, vegla pune, elektrike dhe hidrualike	17	2	19
	Njësi tregtimi lëndësh djegëse, hidrokarbure etj të ngjashme me to.	6	19	25
	Shitje me shumicë, magazina, dyqane etj	205	15	220
	Shitje produktesh farmaceutike dhe të ngjashme me to (depo farmaceutike të regjistruara si biznes i vogël)	27	31	58
	Etj të ngjashme me to	114	1	115
II	Prodhim			
	Përpunim duralumini, metalesh, druri, tapicerie letre, kartoni, plasmasi etj të ngjashme me to	51	17	68
	Prodhim tulla, tjegulla, blloqe betoni, furra gëlqereje, nyje inerte etj, të ngjashme me to	7	20	27
	Prodhime ushqimore, buke, ëmbëlsirash, mishi, peshku, bulmeti, pijesh etj të ngjashme me to.	55	11	66
	Prodhim konfeksione, etj të ngjashme me to.	5	32	37
	Impiante, territore për therrjen e kafshëve etj të ngjashme me to.		2	2
	Impiante, linja për prodhim dhe përpunim e produkteve ushqimore ose të tjera.	3	1	4
	Prodhim përpunim produkte farmaceutike etj të ngjashme me to.		1	1
III	Subjekte ndërtimi			
	Njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi, objekte banimi, shërbimi, të përbëra etj të ngjashme me to ,	4	53	57
	Njësi ndërtimi banesa individuale një- deri në 3 kate mbi tokë (banesa individuale)			

	Rikonstruksione të pjesshme dhe shtesë kati			
	Subjekte ndërtuese për selinë administrative	1	160	161
IV	Njësi Shërbimi			
	Riparimi i artikujve elektro-shtepiake, radio televizorë, frigoriferë, lavatriçe, magnetofon, paisje fonie e të tjera të ngjashme me to.	70	1	71
	Shërbime fotokopjimit, sallon bukurie, autoservise, kurse për makina,(autoshkolla) për traktore, për kompjuter e për parukeri, agjensi doganore,agjensi këmbimi valutë, agjensi turizmi,, konviktet pikat e shërbimit të makinave (autoservis), parkimi i makinave, agjenci transporti, lavanteritë,pastrimi kimik, shërbime të rojeve civile, sallat e lojrave të ndryshme,(gjimnastikë, aerobie, cirqe, kënde lojrash për fëmijë, ping pong, etj.) e të tjera shërbime të ngjashme me shërbimet e lartëpërmendura.	500	37	537
	Shtëpi botuese, biblioteka			0
	Hotele, motele (lekë/dhomë në vit)			0
		5	1	6
	Njësi shërbimi marangoz, rrobaqepës,këpucar, floktore, orëndreqës etj	110	1	111
	Komplekse sportive, palestra, fitnes,pishina, qendra e institute kërkimore-shkencore,salla koncerte-mbledhje e videoteka	18		18
	Shërbimet e klinikat e specialiteteve e ndryshme mjekësore, shërbimet në laboratorët e diagnostifikimeve etj.	66	11	77
	Institucionet jopublike të edukimit (shkollat, kpshtet apo cerdhet, shërbimet në klinikat e specialiteteve të ndryshme mjekësore, shërbimet në laboratorë diagnostifikimi	19	2	21
	Njësi shërbimi financiare dhe Njësi të tjera (që nuk përfshihen në kategoritë dhe nënkategoritë si më lart)	318	88	406
V	Profesionet e lira			
	Avokatët, noter,mjek, mjeku-laborant, stomatologu, farmacisti,ekonomisti kontabël te miratuar, eksperti kontabël te autorizuar, mësuesit, veterinerët, agronomët, botuesit, inxhinier, arkitekti, projektuesi, e të tjera profesione të lira te cilat ushtrohen në njësi fikse apo në ambiente të ndryshme e të tjerë të ngjashëm me to.	167	6	173

	Galeritë e artit të piktoreve, skulptorëve dhe artistëve të tjerë që prodhojnë dhe tregtojnë objekte artistike			
VI	SHOQATA, FONDACIONE, ENTE TË NDRYSHME SHTETËRORE, ORGANIZATA JOQEVERITARE		16	16
VII	Ambulantë			0
	Subjekte që nuk kanë një vendndodhje fikse, taksi, tregtia ambulante në tregje publike dhe private.			0
VIII	Transporti			0
a)	Transport pasagjerësh			0
	Automjet deri 5 vende	311	2	313
	Automjet 6-9 vende		2	2
	Automjet 10-25 vende			0
	Automjet 26-42 vende			0
	Automjet mbi 42 vende			0
b)	Transport Mallrash			0
	Automjet deri 2 tonë			0
	Automjet 2-5 tonë	1		1
	Automjet 5-10 tonë			0
	Automjet 10-16 tonë			0
	Automjet mbi 16 tonë			0

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Kamëz

3.3 Të dhënat mbi tarifën e pastrimit dhe të ardhurat

Tarifat e pastrimit në Bashkinë Kamëz janë të përcaktuara në Vendimin e Këshillit Bashkiak Kamëz nr.120, datë 19.12.2024 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kamëz” të ndryshuar. Tarifës së pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Kamez, në çdo njësi ku ushtrojnë aktivitetin. Katëgoritë, nënkategoritë sipas llojit të veprimtarisë dhe nivelet treguese të Tarifës së Pastrimit janë të shprehura si mëposhtë vijon:²²

²² Vendimi i Këshillit Bashkiak Kamëz nr.120, datë 19.12.2024 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kamëz” të ndryshuar
PMMU Kamëz | 32

Nr.	Aktiviteti	Niveli tarifës Lekë/vit	Niveli tarifës Lekë/vit	Niveli tarifës Lekë/vit
	Kategoria e Biznesit	Biznes I vogël	Biznesi I Madh	VIP
I	Shitje me pakicë			
	Mish, peshk	5000	60000	160000
	Bulmet,fruta, perime, ushqimore	5000	60000	160000
	Artikujt industrialë (veshje, parfumeri, argjendari, etj të ngjashme me to).	5000	60000	160000
	Bar kafe	5000	60000	160000
	Tabakino,Rimbushje Elektronike	5000	20000	60000
	Restorant, fast food etj të ngjashme me to	5000	60000	160000
	Pub, diskoteka etj të ngjashme	5000	60000	160000
	Kafe internet, lojëra fati, qendra interneti	5000	60000	160000
	Tregti materiale të imta, vegla pune, elektrike dhe hidraulike	5000	50000	155000
	Njësi tregtimi lëndësh djegëse, hidrokarbure etj të ngjashme me to.	5000	68000	163000
	Shitje produktesh farmaceutike dhe të ngjashme me to (depo farmaceutike të regjistruara si biznes i vogël)	5000	40000	163000
	Etj të ngjashme me to	5000	55000	155000
II	Shitje me Shumice			
	Magazina, dyqane etj,qe realizojne shitje me shumice	5000	40000	163000
	Materiale të ngurta, inerte, çimento,hekur, dru zjarri, lëndë drusore, import-eksport etj.	5000	83000	163000
III	Prodhim			
	Përpunim duralumini, metalesh, druri, tapicerie letre, kartoni, plasmasi etj të ngjashme me to	5000	113000	213000
	Prodhim tulla, tjegulla, blloqe betoni, furra gëlqereje, nyje inerte etj, të ngjashme me to	5000	112000	212000
	Prodhime ushqimore, buke, ëmbëlsirash, mishi, peshku, bulmeti, pijesh etj të ngjashme me to.	5000	112000	212000
	Prodhim konfeksione, etj të ngjashme me to.	5000	163000	213000
	Impiante, territore për therrjen e kafshëve etj të ngjashme me to.	5000	160000	210000
	Impiante, linja për prodhim dhe përpunim e produkteve ushqimore ose të tjera.	5000	110000	210000
	Prodhim përpunim produkte farmaceutike etj të ngjashme me to.	5000	110000	210000

IV Subjekte Ndertimi				
	Njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi, objekte banimi, shërbimi, të përbëra etj të ngjashme me to ,	5000	100000	200000
	Njësi ndërtimi banesa individuale një- deri në 350 m2 (banesa individuale) Rikonstruksione të pjesshme dhe shtesë kati	5000	15000	30000
	Subjekte ndërtuese për selinë administrative	5000	50000	200000
IV.1 Subjekte Ndertimi				
	Për ndërtimet deri në 350 m2		30000	
	Për ndërtimet deri në 351-1500 m2		100000	
	Për ndërtimet deri në 1501-4500 m2		150000	
	Për ndërtimet deri në 4501-7000 m2		500000	
	Për ndërtimet deri në 7001-10000 m2		700000	
	Për ndërtimet deri në 10001-20000 m2		800000	
	Për ndërtimet mbi 20000 m2		1000000	
V Njësi Shërbimi				
	Riparimi i artikujve elektro-shtepiake, radio televizorë, frigoriferë, lavatriçe, magnetofon, paisje fonie e të tjera te ngjashme me to.	5000	60000	110000
	Shërbime fotokopjimit, sallon bukurie, autoservise, kurse për makina,(autoshkolla) për traktore, për kompjuter e për parukeri, agjensi doganore,agjensi këmbimi valutë, agjensi turizmi,, konviktet pikat e shërbimit të makinave (autoservis), parkimi i makinave, agjenci transporti, lavanteritë,pastrimi kimik, shërbime të rojeve civile, sallat e lojrave të ndryshme,(gjimnastikë, aerobie, cirqe, kënde lojrash për fëmijë, ping pong, etj.) e të tjera shërbime të ngjashme me shërbimet e lartëpërmendura.	5000	60000	160000
	Shtëpi botuese, biblioteka	5000	60000	110000
	Hotele, motele (lekë/dhomë në vit)	5000	60000	110000
		1000	1000	1000
	Njësi shërbimi marangoz, rrobaqepës,këpucar, floktore, orëndreqës etj	5000	60000	110000
	Komplekse sportive, palestra, fitnes,pishina, qendra e institute kërkimore-shkencore,salla koncerte-mbledhje e videoteka	5000	60000	110000
	Lojra me kompjuter, lojra fëmijësh të hapura dhe të mbyllura	5000	60000	110000

	Shërbimet e klinikat e specialiteteve e ndryshme mjekësore, shërbimet në laboratorët e diagnostifikimeve etj.	5000	60000	110000
	Qepje këpucësh me dorë	5000	55000	110000
	Institucionet jopublike të edukimit (shkollat, kopshtet apo cerdhet, shërbimet në klinikat e specialiteteve të ndryshme mjekësore, shërbimet në laboratorë diagnostifikimi	5000	60000	110000
	Njësi shërbimi financiare dhe Njësi të tjera (që nuk përfshihen në kategoritë dhe nënkategoritë si më lart)	5000	60000	130000
VI	Profesionet e lira			
	Avokatët, noter,mjek, mjeku-laborant, stomatologu, farmacisti,ekonomisti kontabël te miratuar, eksperti kontabël te autorizuar, mësuesit, veterinerët, agronomët, botuesit, inxhinier, arkitekti, projektuesi, e të tjera profesione të lira te cilat ushtrohen në njësi fikse apo në ambiente të ndryshme e të tjerë të ngjashëm me to.	5000	60000	110000
	Galeritë e artit të piktoreve, skulptorëve dhe artistëve të tjerë që prodhojnë dhe tregtojnë objekte artistike	5000	60000	110000
VII	SHOQATA, FONDACIONE, ENTE TË NDRYSHME SHTETËRORE, ORGANIZATA JOQEVERITARE		7000	
VIII	Ambulantë			
	Subjekte që nuk kanë një vendndodhje fikse, taksi, tregtia ambulante në tregje publike dhe private.		5000	
IX	Transporti			
a)	Transport pasagjerësh			
	Automjet deri 5 vende	5000	10000	15000
	Automjet 6-9 vende	5000	10000	15000
	Automjet 10-25 vende	5000	10000	15000
	Automjet 26-42 vende	5000	10000	15000
	Automjet mbi 42 vende	5000	10000	15000
b)	Transport Mallrash			
	Automjet deri 2 tonë	5000	10000	15000
	Automjet 2-5 tonë	5000	10000	15000
	Automjet 5-10 tonë	5000	10000	15000
	Automjet 10-16 tonë	5000	10000	15000
	Automjet mbi 16 tonë	5000	10000	15000

I nënshtrohen këtyre tarifave të gjitha familjet e Bashkisë Kamëz. Për katëgorinë tarifa e pastrim-gjelbërimit dhe ndricimit për familjet paguhet nga të gjithë familjet dhe Agjent Tatimor do të jetë Ujësjiellës Kanalizime Kamëz sh.a. Familjet të cilat kanë një kontratë me Ujësjiellës Kanalizime Kamëz do të faturohen cdo muaj në faturën e UKK në shifër të barabartë për 12 muaj. Pra nga janari i vitit korent deri në janar të vitit të ardhshëm. Familjet e Bashkisë Kamëz do të mund ta paguajn faturën pranë cdo sporteli të UKK.

Ujësjiellës Kanalizime Kamëz sh.a do të derdhi cdo muaj shumat e arketuara për keto tarifa pranë cdo Banke të Nivelit të Dytë në numrin e llogarisë së Bashkisë Kamëz.

Për familjet të cilat nuk kanë një kontratë me UKK keto tarifa do të mblihet nga D.T.T.V në bazë të rregjistrimit të gjendjes civile të Bashkisë Kamëz si dhe ato familje që janë banor por pa leje banimi të evidentura sipas rasteve. Paga e tarifave që mblihet nga D.T.T.V, nga familjet të cilat nuk kanë një kontratë me UKK, mund të bëhet pranë zyrave të arketimeve të UKK sipas marrëveshjes të dakortësuar ndërmjet D.T.T.V dhe UKK.

Ujësjiellës Kanalizime Kamëz në rolin e agjentit tatimor përfiton 2.5% të arketimeve totale nga këto tarifë.

Niveli këtyre tarifave është si mëposhtë:

Nr	Emertësa e tarifës	Niveli tarifës për/familje/Lekë
1	Tarifa e Pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit	3.500

Detyrimi për pagesë: Detyrimi për taksat familjare është vjetor.

Përfshihen nga pagesa e gjobës për vonesë në pagesë të gjithë taksapaguesit familjare. (pika 1 e Nenit 114 të ligjit Nr 9920 datë 19.05.2008 i ndryshuar)”

Lehtësira dhe përjashtime:

	Lehtësira dhe përjashtime	Niveli i pageses
1	Invalidët e punës, të verbërit, të sëmurët paraplegjik dhe tetraplegjik (kryefamiljarë) pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit/bashkëshortes). Ose nëse kanë persona madhore por që janë të paaftë për punë ose student.	30% të nivelit të tarifës për familjet
2	Kryefamiljarët gra me mbi një fëmijë në ngarkim (nën 22 vjeç). Jetimët me status të jetimit.	30% të nivelit të tarifës për familjet
3	Kryefamiljarë pensionistë pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit/bashkëshortes) Ose nëse kanë persona madhore por që janë të paaftë për punë ose student.	30% të nivelit të tarifës për familjet
4	Te pa-aftët (kryefamiljarë) pa persona madhorë në ngarkim (mbi 22 vjeç, përveç bashkëshortit/bashkëshortes). Ose nëse kanë persona madhore por që janë të paaftë për punë ose student.	30% të nivelit të tarifës për familje

5	Familjet që jetojnë ne emigracion	0 Leke (Përfshihen nga pagesa e tarifave)
6	Familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike	0 Leke (Përfshihen nga pagesa e tarifave)
7	Familjet që rrjedhin nga i njëjti trung familjar dhe që jetojnë në të njëjtën banesë (nëse nuk kanë banesë) ²³	0 Leke (Përfshihen nga pagesa e tarifave)
8	Familjet e prekura nga projekti infrastrukturor “Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja, Bulevardi i Ri-Shkozë”, si dhe Familjet e prekura nga projekti i Parkut të Liqenit të Paskuqanit	0 Lekë (Përfshihen nga taksat dhe tarifatat vendore”.


3.4 Të dhënat mbi të ardhurat e realizuara nga tarifa e pastrimit

Nr	Kategoria	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
1	Familjare	37,775,025	37,205,107	59,585,083	49,286,473	66,218,441
2	Biznesi i Vogël	83,177,301	80,878,948	84,119,727	86,984,644	112,136,422
3	Biznesi i Madh	11,880,413	10,180,325	12,305,789	11,719,811	17,985,851
4	Biznesi VIP	533,615	786,080	1,481,585	1,042,212	1,972,249
5	Tarifa e Pastrimit nga Lejet e Ndërtimit.	392,741	365,548	865,200	3,084,948	9,942,598

Tabela 4. Të dhëna mbi të ardhurat e realizuara nga Tarifa e Pastrimit dhe Gjellbërimit.

²³ VKB-ja nr. 157, datë 21.12.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB nr. 137 datë 22.12.2021”
PMMU Kamëz | 37

Te ardhura nga tarifat pastrim+gjelberim+ndricim



Grafiku 2. Të ardhurat ndër vite nga tarifa e pastrimit

3.4.1 Planifikimi i të ardhurave nga tarifa e pastrimit për vitet 2025-2029.


Nr	EMERTIMI	Plani	Plani	Plani	Plani	Plani
		Vjetor 2025	Vjetor 2026	Vjetor 2027	Vjetor 2028	Vjetor 2029
1	Tarife pastrimi (biznesi)	118,335,805	121,885,879	125,542,455	129,308,729	133,187,991
2	Taksa dhe tarifa lokale (familjaret)	120,333,458	123,943,462	127,661,766	131,491,619	135,436,367

Tabela 5. Planifimi i të ardhurave nga tarifa e pastrimit 2025-2029

3.4.2 Numri i taksapaguesve në Bashkinë Kamëz

Viti	Total	BM	Bvip	BV
2020	2878	368	16	2494
2021	3170	365	27	2778
2022	3539	494	31	3014
2023	3848	554	39	3255
2024	4033	793	56	3184

Nr.bizneseve ndër vite




Grafiku 3. Numri i bizneseve ndër vite. (Burimi i të dhënave: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Kamëz)

3.4.3 Planifikimi i numrit të bizneseve në Bashkinë Kamëz përgjat periudhës 2025-2029.

Viti	Total	BM	Bvip	BV
2025	4114	809	57	3248
2026	4196	825	58	3313
2027	4280	842	59	3379
2028	4365	858	61	3446
2029	4453	876	62	3515

Parashikimi per 5 vitet



3.5 Të dhëna mbi zhvillimin urbanistik të Bashkisë Kamëz²⁴

Nisur nga miratimi i Planit të Pergjithshëm Vendor i Bashkisë Kamëz miratuar me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.1 Datë 27.07.2022. Lejet e Ndërtimit të miratuara nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit kanë patur rritje progresive si më poshtë:

Viti 2022 janë miratuar gjithsej 108 (njëqind e tetë) Leje Ndërtimi,

Viti 2023 janë miratuar gjithsej 212 (dyqind e dymbëdhjetë) Leje Ndërtimi,

Viti 2024 janë miratuar gjithsej 188 (njëqind e tetëdhjetë e tetë) Leje Ndërtimi.

Parashikimi për vitet e ardhshme:

Për të llogaritur projeksionin e rritjes së banesave për 5 vitet e ardhshme, duke marrë parasysh të dhënat e lejeve të miratuara në vitet 2022, 2023 dhe 2024 (108, 212 dhe 188 leje, respektivisht). Në përmbledhje, projeksioni i rritjes së banesave bëhet duke përdorur mesataren e lejeve të miratuara dhe duke aplikuar norma të mundshme të rritjes vjetore për të parashikuar shifrat për vitet në vazhdim.

VITI	PARASHIKIMET
2025	197 leje/vit
2026	207 leje/vit
2027	217 leje/vit
2028	228 leje/vit
2029	240 leje/vit


Tabela 6. Parashikimi i lejeve të ndërtimit. Burimi i të dhënave: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

²⁴ Sipas të dhënave që administron Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit
PMMU Kamëz | 41

3.5.1 Rrjeti rrugor në Bashkinë Kamëz ku ofrohet shërbimi i pastrimit .

Bashkia Kamëz, ka realizuar investime periodike në rrjetin rrugor. Përgjat viteve 2019-2024 janë asfaltuar 480 km rrugë, për të cilat realizohet shërbimi i pastrimit nga Ndërmarrja e Pastrimit Kamëz.

HARTA E RRUGEVE BASHKIA KAMEZ



Më poshtë gjenden të dhënat përkatëse mbi rrugët që ofrohet shërbimi i pastrimit:

TABELA E RRUGËVE QË OFROHET SHËRBIMI PASTRIMIT			
<u>Nr.</u>	<u>Zona</u>	<u>Emërtimi i rrugës</u>	<u>L (m)</u>
1	Frutikulture & Zall Mnerr	Rruga "Azem Galica" trotuare (Baldushk); Europa Degzim	1200;160;100
2	Kamez 1,5	Rruga "Pekini", Rekjaviku, Policani + seg. paralel me Polican	335;270;330;60
3	Laknas	Rruga "Lura (asfalt+shtylla)", "Fatos Çupi"	1400;160
4	Bathore 1, 2	Rruga "Klenje", "Paralel me Bushtricen 2", "Fajza", "Gryke Çaje"	340;130;140;140
5	Bathore 3,4, & Bulçesh	Rruga "Sllove", "Prezë" "Asim Vokshi"; "Ali Pashë Tepelena"; "Farkë"; "Bexullë"	290;220;270;245;400
6	Bathore 7	Rruga "Gjergj Fishta"	215
7	Valias I Ri	Rruga "Harku I Triumfit"	465;35
8	Valias I Ri	Rikonstruksion Rruga "Berisha"	320
9	Bathore 2	Rruga "2Prilli" Bathore 2 (trotuare), Spahit (trotuare), Zall Dardh	170;150;230
10	Laknas	Rruga "Vlora + Plepat e Brukes"	235;380
NJESIA ADMINISTRATIVE PASKUQAN			
11	Paskuqan 2	Rruga " Rruga Hali Hoxha + Rruga Islam Spahia + Rruga Ded Gjon Luli (Fundi)	485;330;168
12	Paskuqan 1	Rrugët Marin Barleti	832
13	Fushe -Kerçik	Rrugët Ylbere Bylikbashi (Faik Kulla)+ Rruga Xhemal Kada	732;132
14	Babrru Qender	Rrugët Deja + Rruga Bilal Xhaferri + Rruga Bujar Bishanaku	252;410;284
15	Babrru Koder	Rrugët Hasan Zylfia (Trotuare), Rruga Sali Vranishti (Trotuare)	645;940
16	Babrru Koder e Kuqe	Rruga "Nik Ndreka"	472;190
17	Paskuqan 2 Vreshte	Rruga "Fahri Ramadani"	170;230
18	Babrru Qender	Rruga Dea seg	186

19	Paskuqan 1	Ndërtim mure mbajtëse,KUN+Ndrim,Rruga"Havzi Nela+Ilia Kici Dashi"	606
20	Valias	Permireshimi I shtresave rrugore ne aksin e rrugëve "Eilison+Ballsh"	1216
21	Bathore	Permireshimi I shtresave rrugore ne hyrje te shkolles "Halit Coka"	46
22	Kamez,Bathore	Rruga "Demokracia Loti III"	1590
23	Bathore	Rruga "Luz I Vogel"	1100
24	Kamez 4	Rruga "OSBE+Monarkia Shqiptare+BLV Blu"	1405;980;425
25	Kamez 1,2	Rruga Roskovec,segmenti 1,2 +Florida + Rejviku + Berlin + Skrapari + Seg te Rr.Xhorxh Bush + Seg 1 te Blv Donald Trump + Seg 2 te Blv Donald Trump + Seg 3 te Blv Donald Trump + Seg 4 te Blv Donald +Trump + + Zyrih+Altruisti+rruga Drita	1853
26	Kamez 2	Pishtaret e Demokracise + Pavaresia e Kosoves + Pashko Vasa + Mustafa Qemal Ataturku + Athina + Dubai	1241
27	Frutikulture	Rruga "Eilliam Shekspir"+"Sami Frasherit"+ Dituria+Toni Bler+Iballe+Danjel Alia	1550
28	Frutikulture	Rruga pingul "Bulevardi Nene Tereza-Pagesori"+Rruga "Isuf Gervalla" Zallmner+Rruga Brezaret	740;700;680
29	Kamez	Rruga Skenderbeu	975
30	Bathore 6	Rruga Erzeni+Marubi+Valbona+Tomorri	720
31	Bathore 1	Rruga Derjani+Kalaja e Dodes+Rrugicat paralel me Gryk Caje+Rrugica pingul me CO PLAN+seg.te derjani+Voskopojë+28 Nentori+Hotolisht	1700
32	Bathore 4	Rruga Shen Gjergji+Ali Pashe Gucia+Rr.Arberia+seg. pingul me selishten+Vore	440
33	Bathore 7	Rruga Kongresi I Dibres	930
34	Valias I Ri	Rruga Albanet+Rrugicat ne Valias+ Kembanat+trotuaret rruga Amsterdam	1630
35	Valias	Rruga Hamburg+Ylberi+Usaid	704
36	Valias	Rruga Nato+keson	1030
37	Valias	Rruga Kujtesa+rrugicat	830
38	Valias I Ri	Rruga Harku I Triumfit	200

39	Laknas	Rruga Kozare+rruga mbrapa pallateve	580
40	Kamez 5	Rruga ArgjinateAlbavia-Rr.Dajti	1350
41	Valias	Rruga "Jon+Fushe Arrez"	800;580
42	Frutikulture,Zall Mner	Rrugët "Bubullima +Librazhdi +seg.paralel " + "Keshilli I Europes" + "Erseke" 3 seg.Frutikulture+Ndërtim Trotualet + Elketriket e Rrugeve Paqesori + Rr. Besim Çera + Rr. Mustafa Dapi Komplet Zall Mner+zhavorrim I kanalit te Colis	2895
43	Bathore 1	Pedonale "Bashkim Gazidede"	680
44	Laknas	Ura	70
45	Bathore + Frutikulturë	Rrugët Cesh Zadeja + Antena + Borzilok + Hetem Gerbolli + Arbana + Malzi +Luzinia +Rruga Gose + Rruga Farke + Rruga Montral+ Rruga Isuf Xhelili + Rruga Filip Shiroka	1470
46	Bulcesh	Rruga "Hekuran Deda +Jeta e Re + Rruga Gramshi (Segment)"	465
47	Laknas	Rruga "Vesël Coka"	300
NJESIA ADMINISTRATIVE PASKUQAN			
48	Babrru Qender	Rrug Sado Koshenko (Babrru Qender)	610
49	Babru Shpat	Rrugët Zija Kambo + Zylyftar Veleshnja+Rruga Zonja Çurre +Zef Serembe + Rugicat e Themistokli Germenji + Rugicat Tajar Zavalani + Rruga Tom Kola + trotualet Zef Serembe + Vazhdimi i Ziguri Lelo	2600
50	Babru Shpat	Rruga Sulejman Vuciterna +Sulejman Pash Ballgini + Pjeter Arbrori + Sef kosharja + Ukshin Hoti+ Rruga Sef Kosharja + Rruga Maçet + Rruga Sali Vranishti ,	6375
51	Paskuqan 2	Rruga tek Cerdhja e Re,Shkolla Isa Boletini	520
52	Paskuqan 1	Rruga "Haki Taha"	302
53	Paskuqan 1	Rruga Josef Marksel	310
54	Paskuqan 1	Rruga Isa Boletini	505
55	Paskuqan 1	Blloku I Pallateve	495
56	Paskuqan	Pedonale	5200

57	Paskuqan 2 Vresht ,Fush- Kerçik	Rrugët Abdyl Elmazi + Ali Kelmendi Paskuqan Vresht ;Rrugët Xheladin Beqiri + Papa Gjon Pali II ,Fush-Kerçik + Rruga Asim Vokshi Babrru Shpat +Vaso Pasha+ Rruga Josif Mihali+Ahmet Zogu ,Leka Zogu Vresht	2400
58	Kamez 5	Rruga "Azem Hajdari"	1300
59	Zall Mner;Frutikulture	Rrugët "Dyseldorf+Bujari+Prishtina+Rruga pingul me Europeni+Dea+Rruga te Colis+Hiresia"	1650
60	Bathore 4,Bulcesh	Rrugët "Ahtisari+Vaqarr+Vllazerimi "	1395
61	Bathore 7	Rrugët "Haki Stermilli+Ujemisht+Akademia+Dine Doda"	1265
62	Kamez 3;Valias	Rrugët "Shkodra+ rruga pingul me rrugen Jon+Rruga e Re"	1560
63	Laknas	Rruga "Nene Tereza"+ Ndërtim Rrugët " Ramadan Sino+Lukove+Linie+Butrinti+ seg.pingul me rrugen Fushe Arrez"	1930
64	Laknas	Rruga "Shkendija"	1450
65	Valias	Vazhdimi I Harkut te Triumfit	499
66	Bathore 1,2	Rrugët Seg Bulqiza + Rruga Kalis +Seg rruges Torino + Seg rruga Kalersia + Rruga Ferit Uruçi+ Segmment Rruges Derjan + Segment Rruges Pjeter Arbrori ,Rrugët Blloku Bathore 2 , Seg Rruga Zall-Reç + rruga Engjejt , rruga Zerqan , Rruga Adem Ahmet Hysenaj + Seg Rrugët Maqellare	3230
67	Bathore 3+4	Blloku Bathore 3 +4 deri tek Rruga Ibrahim Basha , Rruga Shupenze+ Rruga Padre Mateo Rici + Rruga Tomin+ Rruga Shen pali II + Rruga Pingul me rrugen Skavice + 2 Rruge Paralele me Rrugen Skavice + Rruga Paralel me Rrugen Arbrit	1900
68	Kamez	Rruga Fushe arrez	552
NJESIA ADMINISTRATIVE PASKUQAN			
69	Babrru koder e kuqe	Rrugët "Ndreko Rino+ Mustafa Xhani"	985


70	Paskuqan 1	Rrugët " Josif Mihali + rrugicat(Rruga pingul me Lidhja e Prizrenit +Jusuf Gervalla) + Llazo Palluqi + Llambro Andoni + Memo Meta"	1459
71	Paskuqan 2, Vreshte	Rrugët "Riveshje Rruga Hajri Skeja , Paskuqan 2 , Vreshte+ Rruga Ali Demi dhe Rruga Pingul me Pedonalen ne Paskuqan 1 "	1525
72	Paskuqan 2, Vreshte	Rrugët "Agim Nivica +Segmenti I Rruges Adem Jashasri +2 Rrugica pingul me Rrugen Abdyl Elmazi + Hajri Skeja + Gani Duraku "+Rruga Hysen Cino (ndricimi)+Ali Ibra	1610
73	Paskuqan 2, Fushe	Haziz Ndreu +Filip Shiroka Rruga " Asdreni +Vehbi Dibra + Irfan Strazimiri + Demir Gashi + Nikoll Kacorri +Iliaz pashe Dibra+ Dede Plani"	1679
74	Blloku 1, Babrru, Koder	Rrugët "28 Nentori "+1 Maji "	1648
75	Blloku 2, Babrru- Koder	Rrugët "Vojo Kushi + Vicens Prenushi+Rruga pingul me Koferencen e Mukjes+Shtejfen Gjecovi"+Mihal Grameno	1131
76	Paskuqan 1,Koder	Rrugët : Mbretresha Geraldin + Rruga Teuta+ Rruga Mbreti Gent+ Rruga Mati Prenushi + Rruga Abaz Hoxha + Seg Rruges Mark Tirta + Rruga Koço MUKA + Trotuare e Rruges Mark Tirta Paskuqan 1 Koder +Rruga "Mehmet Gjevori +seg.pingul me rrugen Demokracia " , Njesia Administrative Paskuqan , Bashkia Kamez	2704
77	Kamez 5	Rruga "Burim"	225
		Rruga "Gucia"	145
		Rruga "Faik Hoxha (ish Miqesia)+3 pingulet me Faik Hoxhen	770
78	Blloku 1 Bathore 7	Rruga "Dibra"	224
		Rruga "Aspirata"	219
		Rruga "Paralel me AMC"	98
		Rruga "AMC"	164
		Rruga "Qaf Mali"	226
		Rruga "Don Nikoll Kacorri"	230
		Rruga "Pingul me Blv Nene Tereza (tek market Bala)	212
		Rruga "2 Seg.pingul me Demokracine"	121
79	Blloku 2 Bathore 7	Rruga "Teuta,Kacaniku,Kelmendi"	600,330,330
		Rruga "Seg Kacaniku+Legjendaret"	450
		Rruga "Delvine"	650

		Ruga "Jezerce"	147
80	Blloku 3 Bathore 7	Ruga "Margegaj"	215
		Ruga "Shishtavec"	215
		Ruga "Terthore"	215
		Ruga "Topojan"	215
		Ruga "Shtiqen"	215
		Ruga "Surroi"	215
		Ruga "Paralel me Llugaj"	440
81	Blloku 4 Bathore 7	Ruga "Zapod"	215
		Ruga "Kol Idromeno"	215
		Ruga "Frang Bardhi"	217
		Ruga "Gjon Buzuku"	217
		Ruga "Jeronim De Rada"	213
		Ruga "Syri I Kalter + seg 1"	272
		Ruga "Hena, Neptuni "	150
		Ruga "Helmut Kol "	110
82	Blloku 5 Bathore 7	Ruga "Lucie Miloti "	217
		Ruga "Lek Dukagjini "	220
		Ruga "Peqini "	220
		Ruga "Marie Logoreci "	290
		Ruga "Paralel me Peqinin "	150
		Ruga "Pingul me Azem Hajdarin"	165
		Ruga "Synej+Seg1,2"	620
83	Valias	Ruga "Pjeshkore, Velipoje +rrugicat"	705
		Ruga "Pingul me Hekuran Deda"	300
		Ruga "Ballsh" Vazhdim	610
84	Valias	Ruga "Korabi"	850
		Albanet (Pjesa e pare)	500
		rrugicat pingul me rrugen Gjirokaster	350
85	Frutikulture	Pedonale nga Ruga Liria-Skenderbeu	1072
		Ruga "Zit Noka"	525
86	Frutikulture	Ruga "Ernest Koliqi"	107
		Ruga "Silvio Berluskoni"	1030
		Ruga "Sander Prosi+Qemal Stafa"	400

87	Laknas	Rruga "Lunxheria"	805
		Rruga "Paralel me Lunxherine"	45
		Rruga "Pingul me Durresi"	180
		Seg."pingul me rrugen Lure"	70
		Rruga "Korcare"	140
		Rruga "Kozare"	250
88	Valias	Rruga "Jupiteri"	220
89	Kamez 5	Rruga Nene Tereza	1700
NJESIA ADMINISTRATIVE PASKUQAN			
90	Babrru Koder e Kuqe	Rruga "Mustafa Kruja"	250
		Rruga "Musa Fratari"	380
		Rruga "Myslim Peza"	240
		Rruga "Mustafa Kacaci+Mustafa Ataturku"	270
		Rruga "Mujo Ulqinaku"	150
		Rruga "Pingul me Azem Hajdari"	130
91	Babrru Koder e Kuqe	Rruga "Xhemali Dervishi"	238
		Rruga "Pingul me rrugen Xhemali Dervishi"	165
		Rruga "Pashko Vasa"	530
92	Babrru Koder e Kuqe	Rruga "Betim Muco"	896
93	Paskuqan 1 Koder	"Seg.Lidhja e Prizerenit"	174
		Rruga "Lasgush Poradeci+seg"	312
		Rruga "Laze Shantoja"	168
		Rrugët "Lefter Talo"+Lek Sidromi"	350,160
94	Paskuqan 1	Rruga "Hasan Tahsin"	310
		Rruga "Hasan Gerxhaliu"	390
		Rruga "Haxhi Isuf Banka"	280
		Rruga "Inajete Dumi"	160
		Rruga "Asim Aliko 1+Asim Aliko 2"	617
95	Paskuqan 1	Rruga "Hoxha Tahsim"	110
		Rruga "Hajredin Bylyshi"	297
		Rruga "Dhori Qirjazi"	82
		Rruga "Shen Ismaili"	155

96	Paskuqan	Rruga Isa Boletini"	507
		Rruga Halim Xhelo"	390
		Rruga "Ali Demi"	1200

4 ASPEKTET INSTITUCIONALE NË MENAXHIMIN E MBETJEVE URBANE ²⁵



Grafiku 4. Hierarkia e menaxhimit të mbetjeve urbane. Skema e organizimit institucional në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor.

²⁵ Vendimi nr. 418, datë 27.5.2020 "Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2025-2030"

4.1 Organizimi në nivel qendror

Aktorët kryesorë përgjegjës, në nivel kombëtar, në fushën e menaxhimit të mbetjeve janë Ministria e Mjedisit (MM), Ministria e Zhvillimit Urban (MZHU), Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (MTI), Ministria e Shëndetësisë (MSH), Ministria e Energjisë dhe Industrisë (MEI), Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave (MBZHRAU), si dhe Ministria e Financave (MF).

MM është institucioni i specializuar dhe përgjegjësi kryesor për hartimin e politikës së menaxhimit të mbetjeve; hartimin e legjislacionit, udhëzuesve dhe rregulloreve dhe zbatimin në nivel qendror me anë të dy autoriteteve të specializuara në varësi të saj: Inspektorati Mjedisor (IM) dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit (ARM).

MZHU zbaton politikat kombëtare dhe rajonale në planifikimin e territorit për depozitimin e mbetjeve të zonave urbane dhe rajonale përkatëse për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit.

MTI ka si mision të udhëheqë, të planifikojë, të koordinojë dhe të monitorojë aktivitetin e trajtimit dhe depozitimit të mbetjeve të ngurta urbane dhe mbetjeve të ndërtimit në të gjitha fazat e zhvillimit, si projektimi, zbatimi i punimeve dhe shfrytëzimi i lëndësve dhe impianteve të incenerimit të mbetjeve urbane.

MSH harton rregullore për menaxhimin e mbetjeve dhe zbaton rregulloren për mbetjet spitalore.

MEI është përgjegjëse për hartimin e rregulloreve për (i) Mbetjet industrial, (ii) Mbetjet minerale. Të dyja nuk janë hartuar ende; si dhe rehabilitimin e venddepozitimeve.

MBZHRAU është përgjegjëse për hartimin e rregullores për mbetjet bujqësore dhe shtazore. Rregullorja nuk është hartuar ende.

MF është përgjegjëse për hartimin e legjislacionit për taksat e ndryshme mjedisore. Deri tani janë paraqitur dy taksat e para mjedisore (taksa e gjelbër dhe taksa e ambalazhimit mbi pijet).

4.2 Organizimi në nivel rajonal

Inspektorati Mjedisor është përgjegjës për garantimin e mbrojtjes së mjedisit në nivel qendror dhe për kontrollin dhe zbatimin e legjislacionit mjedisor. Ai vendos penalitete për shkeljet administrative apo mund të pezullojë aktivitete që nuk janë në përputhje me legjislacionin mjedisor; informon rregullisht autoritetet lokale për gjendjen e mjedisit, aktet ligjore dhe projektet e miratuara; kontrollon regjistrin e ndotësve, rregulloret teknike dhe


teknologjitë.

Agjencitë Rajonale të Mjedisit janë autoritete të specializuara për monitorimin dhe mbrojtjen e mjedisit në nivel rajonal. Kanë përgjegjësi në miratimin e vendeve të grumbullimit të mbetjeve dhe japin, në bashkëpunim me autoritetet vendore, lejet mjedisore për impiantet lokale të mbetjeve apo aktivitete të tjera lokale.

Këshilli Kombëtar për Rregullimin e Territorit, miraton lejen e sheshit dhe lejen e ndërtimit për objektet (si rrjedhojë edhe për *landfill*-et) me një sipërfaqe më të madhe se 0.5 ha që ndërtohen jashtë kufijve administrative të sipërfaqeve të qytetit/fshatit/zonave të banuara.

Inspektorati Sanitar Shtetëror ka për detyrë të kontrollojë dhe ndërmarrë veprime për të siguruar kushtet e nevojshme higjieno-sanitare për aktivitetet e ndryshme. Ai ka për detyrë të vendosë gjopa për probleme që lidhen me mospastrimin e zonave urbane apo kur grumbullimi dhe depozitimi janë jo të përshtatshëm dhe bëhen të rrezikshëm për popullsinë.

4.3 Organizimi në nivel lokal (Bashkia Kamëz)



Struktura e organizimit të Ndërmarrjes së Pastrimit Kamëz, Bashkia Kamëz.

Detyrat dhe përgjegjësitë: bazuar në ligjin nr. 139/2015, ligjin 8094/1996, dhe në ligjin nr. 9010/2003, NJQVtë janë përgjegjëse për të organizuar shërbimin e grumbullimit, transportit, trajtimit dhe depozitimit final të mbetjeve, duke i deleguar këto shërbime PMMU Kamëz | 52

organeve lokale ose duke kontraktuar një kompani private të specializuar. Bashkia Kamëz realizon vetë menaxhimin e mbetjeve urbane që nga viti 2024. Struktura kompetente për realizimin e shërbimit dhe menaxhimit të mbetjeve urbane është Ndërmarrja e Pastrimit, institucion në varësi të Bashkisë Kamëz²⁶.

5 TRAJTIMI I MBETJEVE NË BASHKINË KAMËZ

5.1 Situata e pastrimit në vitin 2014:

Në vitin 2014, para bashkimit të njësive Kamëz dhe Paskuqan në Bashkinë e sotme të Kamzës, menaxhimi i mbetjeve urbane paraqiste probleme serioze në të dy zonat.

Në Kamëz, me një popullsi prej rreth 86,000 banorësh, shërbimi mbulonte vetëm 70% të territorit. Bashkia menaxhonte vetë grumbullimin dhe transportin e mbetjeve përmes një sistemi të kufizuar me 250 kontenierë dhe një kamion 7-tonësh, i cili mbulonte kryesisht qendrën e qytetit. Mbetjet depozitoheshin pa trajtim pranë lumit Tërkuza, duke ndotur mjedisin dhe kërcënuar cilësinë e ajrit dhe ujërave nëntokësore. Në zonat e pambuluara, 94% e banorëve menaxhonin mbeturinat në mënyrë individuale, shpesh duke i djegur ose hedhur në ambiente të hapura, duke krijuar një rrezik të madh shëndetësor dhe mjedisor.

Në Paskuqan, situata ishte edhe më problematike, me vetëm 35% të popullsisë (rreth 15,000 banorë) të mbuluar nga shërbimi i pastrimit. Mbetjet shpesh hidheshin në mënyrë të pakontrolluar në lumin e Tiranës, duke shkaktuar ndotje të lartë. Edhe pse komuna kishte kontraktuar një kompani private me një flotë të kufizuar, mbetjet inerte dhe urbane përfundonin në rrugë apo ambiente të hapura, duke rrezikuar shëndetin e banorëve.

Bashkimi i Paskuqanit me Kamzën solli nevojën për një menaxhim më të mirë të mbetjeve urbane, përmes zgjerimit të mbulimit të shërbimit, investimeve në infrastrukturë dhe ndërgjegjësimi të komunitetit për riciklim dhe praktika të qëndrueshme.

5.2 Situata me pastrimin pas kalimit të shërbimit të koncesionari

Në vitin 2018, Bashkia Kamëz lidh një kontratë me koncesionarin Eco-Cleaning për shërbimin e pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve urbane, me një vlerë totale prej 1.35 miliardë lekë për një periudhë 12-vjeçare. Kjo kontratë parashikonte një kosto vjetore prej 112.5 milionë lekë, e cila përfshinte grumbullimin, transportimin, seleksionimin dhe depozitimin e mbetjeve. Sidoqoftë, një shqyrtim i detajuar i kontratës ka nxjerrë në pah disa problematika, përfshirë disbalancat në sasinë e mbetjeve të grumbulluara, që nga 80,000 tonë në vit ka rënë në rreth 34,000 tonë, duke krijuar një situatë të pasigurt për vlerësimin e kostove. Po ashtu, ndryshimet e shpeshta në itinerarët e shërbimit

²⁶ Struktura e Ndërmarrjes së Pastrimit miratuar Vendimi nr.288, datë 10.01.2025

dhe urbanizimi i shpejtë i Bashkisë, duke përfshirë shtimin e rrugëve dhe zonave të reja që nuk ishin parashikuar në kontratë, kanë bërë që shërbimi të mos jetë më i përshtatshëm dhe të krijohet një ngarkesë për operatorin.

Në vitin 2024, Bashkia Kamëz ka vendosur të rikthejë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve tek Ndermarrja e Bashkisë për të lehtësuar këto problematika. Ky kalim ka ardhur pas vështirësive që ka hasur Bashkia Kamëz me koncesionarin, përfshirë ndryshimet e itinerarëve të shërbimit, mungesën e mbulimit të zonave të reja dhe ndryshimet e papritura në urbanizim që kanë sjellë vonesa dhe papërputhje me shërbimin. Gjithashtu, ky kalim ka mundësuar një kontroll më të ngushtë dhe një menaxhim më efikas të shërbimit të pastrimit dhe mbetjeve, duke siguruar që çdo zonë të jetë mbuluar siç duhet dhe me kushte të përshtatshme për zhvillimin e mëtejshëm të bashkisë.

Në korrik të vitit 2024 me Vendim të Kshilli bashkiak është krijuar Ndermarrja e Pastrimit Kamëz si nevojë emergjente për të zgjidhur situatën e krijuar mbi menaxhimin e mbetjeve urbane.

5.3 Analizë e situatës aktuale të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në bashkinë Kamëz

Bashkia Kamëz pas marrjes së 350 kontinierëve metalik, me vëllim 1,600 m³ si dhe pas riparimit të koshave ekzistues, sot kemi 300 pika të përcaktuara nga bashkia për grumbullimin e mbetjeve të ngurta urbane, kryesisht me nga dy dhe tre konteiner për një PMG. Gjithashtu në shumë lagje mundësohet shërbimi i marrjes së mbeturinave derë më derë.

Për lehtësi organizimi pune, shërbimi i pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve urbane është e organizuar sipas zonave.

1. Zona e parë mbulon zonën urbane, (Lagjen Administrative nr 2)
2. Zona e dytë përfshin lagjen administrative nr 3 Bathore,
3. Zona e tretë përfshin lagjen administrative nr 4 Paskuqan
4. Zona e katërt përfshin lagjen administrative nr 1 Laknas-Valias.

Ndërmarrja e Pastrimit Kamëz, si institucion në varësi të Bashkisë Kamëz organizohet në 9 (nëntë) sektorë si më poshtë, vijon:

- Sektori Ligjor dhe Burimeve Njerëzore
- Sektori i Financës
- Sektori i Shërbimeve Mbështetëse
- Dega Teknike
- Sektori i Pastrimit Kamëz
- Sektori i Pastrimit Laknas-Valias
- Sektori i Pastrimit Bathore
- Sektori i Pastrimit Paskuqan
- Sektori i Ngarkim Shkarkimit

5.3.1 Analiza e performancës së shërbimit të pastrimit për vitin 2024

- Numri total i koshave në përdorim është 350 kontenierë.
- Sipërfaqja totale e rrugëve që pastrohen janë 480 km, nga të cilat, afërsisht 120 km pastrohen çdo ditë.
- Makineri pastrimi (makina teknologjike) në total janë 9 copë.
- Popullsia totale në Bashkinë Kamëz është 150,101 banorë.
- Popullsia në Kamëz është 98,486 banorë
- Popullsia në Paskuqan është 51,615 banorë
- Pika të vendqëndrimit të koshave (PGM) janë në total 300.
- Popullsia e mbuluar me shërbim të mbledhjes së mbeturinave dhe pastrimit me fshesë (manual) është 100%.
- Popullsia e mbuluar me shërbim në qytet është 100%
- Popullsia e mbuluar me shërbim në njësitë administrative është 100%
- Frekuenca e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve urbane (mesatare Q + NjA) në qytet dhe Njësi Administrative:
 - Frekuenca në Kamëz është 4 herë / ditë
 - Frekuenca në Njësitë Bathore, Paskuqan, Valias – Laknas është 1 herë / ditë.

1. Makineri pastrimi në total janë:

<i>Nr</i>	<i>Lloj</i>	<i>Sasia/Copë</i>	<i>Kapaciteti m³</i>
1	Makina Teknologjike	3	20 - 23
2	Makina Teknologjike	4	10 - 12
3	Makina Teknologjike	2	8 - 10
4	Makinë fshirje mekanike	1	

2. Frekuenca e pastrimit të pikave, të ndara sipas zonave është :

<i>Nr</i>	<i>Zona</i>	<i>Frekuenca në herë</i>
1	Kamëz	4
2	Paskuqan	1
3	Laknas – Valias	1
4	Bathore	1

5.3.2 Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve urbane në Bashkinë Kamëz

Në parashikimin e shërbimeve të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve, bashkia duhet të marrë në konsideratë parimin për parandalimin e ndotjes. Cilësia dhe kostot e shërbimit të mbledhjes dhe largimit të mbetjeve urbane lidhen drejtpërdrejtë me mënyrën se si konsumatorët hedhin mbetjet, respektojnë oraret e përcaktuara dhe zbatojnë rregullat lokale për menaxhimin e mbetjeve. Në këtë aspekt, bashkia duhet të plotësojë kuadrin e saj rregullaror në sajë të:

- a) Hartimit të një rregulloreje vendore për menaxhimin e mbetjeve, ku do të përcaktohen procedurat, protokollet e punës, parashikimet se çfarë do të ndodh në rast avarish apo

aksidentesh në punë, të drejtat dhe detyrimet e të gjitha grupeve të interesit të përfshira në menaxhimin e mbetjeve si dhe gjobat përkatëse në rast të shkeljeve të evidentuara. Si parakusht, bashkia duhet të caktojë një grup pune për monitorimin dhe për të vënë në zbatim këto rregulla;

- b) Parandalimin e hedhjes së paligjshme të mbetjeve jashtë kontenierëve me anë të fushatave të ndërgjegjësimit dhe programeve të edukimit;
- c) Marrëveshje me konsumatorët e mëdhenj, për të përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrimet e secilës palë, për dorëzimin e mbetjeve në pikat e caktuara nga bashkia, ose grumbullimi i tyre nga bashkia, në sajë të një kontrate të veçantë, në pikat e gjenerimit të tyre.
- d) Përveç këtyre elementëve, bashkia duhet të marrë në konsideratë edhe faktorë të tjerë gjatë planifikimit të sistemit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve:

Orare pune efektive dhe të përshtatshme: Për të operuar sipas nevojave të pastërtisë dhe në mënyrë të efektshme dhe me kosto të ulët, bashkia duhet të hartojë një program të përshtatshëm pune që merr parasysh ndryshimet ditore, javore dhe mujore në lidhje me numrin e banorëve dhe veprimtarive tregtare.



Numri i duhur i kontenierëve: Për të ofruar një shërbim të efektshëm dhe me kosto të ulët, bashkia duhet të sigurojë numrin e duhur të kontenierëve apo koshave dhe rregullsinë e mbledhjes së mbetjeve.

Itenerar efektiv për mbledhjen e mbetjeve: Përcaktimi i saktë i itenerarit për makinat e mbetjeve do të ulë koston për mbledhjen e mbetjeve.

Rritja e rendimentit në punë: Këtu futen mekanizmat që përfshijnë përmirësimin e kushteve të përgjithshme të punës, pajisja me uniformë, stimujt për punë të mirë, trajnimi dhe forcimi i punës në grup.

Për ofrimin e shërbimit në Bashkinë Kamëz janë angazhuar një total prej 15 kamionësh prej të cilëve 9

janë kamionë teknologjik dhe 6 (dum dum dhe kamioncina). Këta makineri janë në pronësi të Ndërmarrjes së Pastrimit, Bashkia Kamëz.

Ato kryejnë shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve urbane në ditë të ndryshme në secilën nga njësitë, dhe më pas shkojnë në landfillin e Sharrës për të depozituar mbetjet.



Mjetet Teknologjike gjatë realizimit të shërbimit të pastrimit.



Makinat Teknologjike me mesazhet sensibilizuese



1.3 Kontenierët

Bashkia Kamëz e ka ofruar shërbimin nëpërmjet një totali prej 350 kontinieresh metalik, me vëllim 1,600 m³. Këta kontenierë janë të vendosur në 300 pika të përcaktuara nga bashkia për grumbullimin e mbetjeve të ngurta urbane, kryesisht me nga dy dhe tre kontenjerë për një pikë grumbullimi. Në disa lagje mundësohet shërbimi derë me derë .



Në Bashkinë Kamëz kryhet dezinfektim i kontenierëve 1 herë në 3 ditë. Dezinfektimi i pikave të grumbullimit të mbetjeve kryhet në mënyrë frekvente me klor dhe dezinfektant specifik sipas një grafiku pune, me shpeshtësi nga 1 deri në 8 herë në muaj.

Veprimtaria kryhet në pikat e grumbullimit të mbetjeve ku kontenierët ndodhen, gjatë shërbimit të mbledhjes së mbetjeve, ndërsa për larjen, kur ky proces kryhet, kontenierët zhvendosen fizikisht.

Mirëmbajtja e përshtatshme e kontenierëve dhe makinave të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve: Mirëmbajtja dhe riparimi i specializuar i makinave dhe pajisjeve sipas standardeve të riparimit janë çështje të rëndësishme për shërbimin e grumbullimit të mbetjeve.

Shërbimi i mbledhjes dhe transportit të mbetjeve në Bashkinë Kamëz aktualisht është i organizuar nëpërmjet 4 zonave të shërbimit. Zona e parë mbulon zonën urbane, praktikisht Lagjen Administrative nr 2 Kamëz , zona e dytë përfshin lagjen administrative nr 3 Bathore , zona e tretë përfshin lagjen administrative nr 4 Paskuqan dhe zona 4 përfshin lagjen administrative nr 1 Laknas-Valias. Popullsia totale që merr shërbim në të gjithë bashkinë Kamëz është 100% .



Imazhe të kontenirëve në Bashkinë Kamëz.

5.4 Depozitimi dhe Trajtimi i Mbetjeve në Bashkinë Kamëz

Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve janë procese shumë të rëndësishme për menaxhimin e mbetjeve dhe ruajtjen e mjedisit. Bashkia Kamëz ka një sistem të organizuar për menaxhimin e mbetjeve, ku të gjitha mbetjet që grumbullohen nga shërbimi i mbledhjes, depozitohen në landfillin e Sharrës, i cili është i vendosur rreth 15 kilometra larg nga qendra e bashkisë.

Çdo mjet grumbullimi, pas përfundimit të shërbimit të tij, drejtohet në landfillin e Sharrës. Ky landfill është një nga vendet ku mbetjet dërgohen për të kaluar në proceset e trajtimit dhe menaxhimit të mbetjeve të ngurta. Në këtë landfill, mbetjet mund të kalojnë në procese të tilla si shkrirja, dekompozimi ose në disa raste riciklimi i materialeve që mund të rikupërohen. Landfilli i Sharrës ka një rol kyç në menaxhimin e mbetjeve të bashkisë Kamëz, duke siguruar një vend të përshtatshëm për depozitimin e mbetjeve dhe duke minimizuar ndikimin negativ të mbeturinave në mjedis. Përveç kësaj, ai ofron një mundësi për trajtimin e mbetjeve në mënyrë që ato të mund të menaxhohen me sa më pak ndikim në mjedis, duke i mbajtur ato larg zonave të banuara dhe duke i siguruar një trajtim të sigurt.

Në territorin e Bashkisë Kamëz nuk kemi vende depozitimi mbetjesh pasi Bashkia Kamëz ka një akt-marrëveshje me Shoqërinë “INTEGRATED ENERGY BV SPV” e nënshkruar me **ADMINISTRATORIN SHTETËROR**, “Për depozitim të mbetjeve urbane në Zonën e Trajtimit të Mbetjeve Tiranë” sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Mbetjet urbane në Bashkinë Kamëz trajtohen në Zonën e Trajtimit të Mbetjeve Tiranë që është dhe zona e përcaktuar për depozitimin e mbetjeve urbane për Bashkitë e Qarkut Tiranë. Bashkia Kamëz nuk komposton mbetjet, pasi të gjitha mbetjet trajtohen në Zonën e Trajtimit të Mbetjeve Tiranë.

Referuar faktit që territori i Bashkisë Kamëz është një zonë në tërësi teje e urbanizuar, si dhe faktit që nuk ka hapësira territoriale të disponueshme në pronësi të Bashkisë Kamëz, nuk ka bërë të mundur përcaktimin e një zone për vendepozitimin e mbetjeve urbane.

5.5 Reduktimi i Mbetjeve Urbane

Shqipëria ka avancuar në politikat për reduktimin e mbetjeve duke e përfshirë këtë çështje në agjendën e saj kombëtare dhe duke e mbështetur në direktivat e Bashkimit Europian. Plani Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve (PKMM 2020-2035) është një dokument kyç që përcakton strategjitë për menaxhimin e mbetjeve, duke synuar reduktimin e ndikimeve

mjedisore, riciklimin, dhe përpunimin e mbetjeve me qëllim përfitimin e energjisë. Shtyllat kryesore të kësaj strategjie përfshijnë planifikimin, edukimin dhe forcimin e kapaciteteve institucionale, duke përfshirë bashkitë për menaxhimin e mbetjeve dhe ngritjen e infrastrukturës së nevojshme

Po ashtu, politikat e Bashkimit European mbi mbetjet përfshijnë Direktivën Kuadër të Mbetjeve, që nënvizon rëndësinë e hierarkisë së mbetjeve dhe miratimin e masave për reduktimin e mbetjeve në nivel kombëtar e lokal. Bashkimi European ka mbështetur Shqipërinë në realizimin e këtyre politikave me fonde IPA dhe nëpërmjet ndihmës teknike dhe financiare për ndërtimin e kapaciteteve për menaxhimin e mbetjeve

Në kontekstin e Bashkisë Kamëz, është e rëndësishme që të identifikohen mundësitë për ndërtimin e një qendre riciklimi me impakt të ulët mjedisor, duke siguruar grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve në përputhje me këto politikat kombëtare dhe ato të Bashkimit European. Kjo mund të realizohet përmes investimeve në infrastrukturën e nevojshme dhe duke forcuar kapacitetet organizative dhe financiare për menaxhimin efikas të mbetjeve

Edhe pse ende nuk ka një orientim të qartë dhe ka boshllëqe ligjore, Bashkia Kamëz ka një synim të rëndësishëm për të reduktuar mbetjet përmes grumbullimit të diferencuar të mbetjeve të riciklueshme. Ky proces do të nisë fillimisht në zonat urbane dhe, gradualisht, do të shtrihet edhe në pjesët e urbanizuara të fshatrave. Aktualisht, bashkia parashikon që rreth 30% e mbetjeve të riciklueshme mund të ndahen për riciklim, përfshirë katër rrymat kryesore: letër/karton, metale, plastikë dhe qelq. Megjithatë, ky proces është ende në fazat fillestare dhe mbetet një synim i ardhshëm i bashkisë, pasi kërkon një angazhim të madh për të përmbushur sfidat ligjore dhe infrastrukturore të nevojshme.

Në politikat që po harton Bashkia Kamëz, është parashikuar që, në të ardhmen, të bëhet një kalim gradual drejt ndarjes në burim të mbetjeve dhe riciklimit të tyre, duke siguruar një menaxhim më të efektshëm të mbetjeve dhe një ndikim më të ulët në mjedis. Ndarja në burim dhe riciklimi janë procese thelbësore për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve, pasi ato jo vetëm që ndihmojnë në uljen e sasive të mbetjeve që depozitohen në landfill, por gjithashtu kontribuojnë në ruajtjen e burimeve natyrore dhe zvogëlimin e ndotjes. Ky është një hap i rëndësishëm në drejtim të një mjedisi më të pastër dhe më të qëndrueshëm për të ardhmen, që do të përfshijë angazhimin e qytetarëve dhe të institucioneve për të implementuar politikat e riciklimit në mënyrë të suksesshme.

Po ashtu, objektivat e Shqipërisë për integrimin në Bashkimin European kërkojnë një përputhje më të madhe me politikat mjedisore të BE-së, ku riciklimi dhe menaxhimi i mbetjeve janë ndër prioritetet kryesore. Pjesë e këtyre angazhimeve është edhe strategjia kombëtare e menaxhimit të mbetjeve, e cila synon të reduktojë ndjeshëm sasinë e mbetjeve që depozitohen në landfill. Ky proces jo vetëm që synon uljen e ndotjes dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit, por gjithashtu ka për qëllim zgjerimin e jetës funksionale të landfill-eve, duke shtuar mundësitë për trajtimin e mbetjeve në mënyra të qëndrueshme. Për më tepër, strategjia promovon praktikën e "3R" (Reduktimi, Riciklimi, Ripërdorimi), të cilat janë themeli i një ekonomie qarkulluese, ku burimet natyrore shfrytëzohen në mënyrë më efikase dhe mbetjet trajtohen si burim i mundshëm për produkte të reja. Kjo strategji është e integruar në kërkesat e BE-së dhe është një hap i rëndësishëm për të realizuar qëllimet e integritetit european, duke krijuar mundësi për zhvillimin e qëndrueshëm dhe një menaxhim më efikas të mbetjeve në nivel kombëtar dhe lokal.

Në kuadër të politikave të Bashkisë Kamëz, ndarja në burim dhe riciklimi janë të integruara si dy procese thelbësore për menaxhimin e mbetjeve dhe për ruajtjen e mjedisit. Ndarja në burim, e cila do të fillojë në zonat urbane dhe gradualisht do të përhapet në zonat e urbanizuara të fshatrave, synon që qytetarët dhe bizneset të ndajnë materialet e riciklueshme si letër, plastikë, qelq dhe metal nga mbeturinat e tjera që nuk mund të riciklohen. Ky proces do të lehtësojë ndarjen dhe përpunimin e mbetjeve për riciklim dhe do të rrisë cilësinë e materialeve të riciklueshme, duke kontribuar në reduktimin e mbetjeve që shkojnë në landfill.

Për më tepër, riciklimi është një proces që Bashkia Kamëz e konsideron si një mënyrë për të përpunuar dhe kthyer materialet e përdorura në produkte të reja, duke reduktuar kështu nevojën për burime të reja natyrore dhe energji. Ky proces është i rëndësishëm për të ulur ndikimin negativ në mjedis dhe për të siguruar një menaxhim më efikas të mbetjeve.

Në këtë drejtim, Bashkia Kamëz ka në plan ndërtimin e stacioneve ndërmjetëse, që do të mundësojnë selektimin dhe paketimin e mbetjeve për riciklim dhe kompostimin e mbetjeve të biodegradueshme. Këto stacione do të përfshijnë grumbullimin, pastrimin dhe klasifikimin e mbetjeve në grupe të ndryshme për t'u dërguar më pas në përpunim të specializuar. Kjo do të ndihmojë në përmirësimin e eficiencës së menaxhimit të mbetjeve dhe do të kontribuojë në uljen e sasisë së mbetjeve që përfundojnë në landfill.

Një tjetër hap i rëndësishëm për Bashkinë Kamëz është shqyrtimi i mundësive për identifikimin e një territori të përshtatshëm me ndikim të ulët mjedisor për ndërtimin e një Qendre Riciklimi. Kjo do të mundësojë përpunimin e mëtejshëm të materialeve të riciklueshme, duke u siguruar që impakti mjedisor i operacioneve të riciklimit të jetë minimal. Bashkia ka synim të krijojë një Qendër Riciklimi që do të shërbejë si një pikë grumbullimi dhe përpunimi për të gjitha materialet e riciklueshme, duke ofruar një mundësi për të rritur kapacitetet e riciklimit në të gjithë territorin.

Bashkia Kamëz ka gjithashtu për qëllim:

- **Grumbullimin e mbetjeve që janë ndarë në burim.**
- **Pastrimin dhe përgatitjen e materialeve për riciklim (si pastrimi i plastikës ose thyerja e qelqit).**
- **Klasifikimin e mbetjeve në grupe të ndryshme për t'u dërguar më pas në përpunim të specializuar.**
- **Krijimin e një Qendre Riciklimi me ndikim të ulët mjedisor për përpunimin dhe riciklimin e materialeve të grumbulluara.**
- **Përmirësimin e eficiencës së menaxhimit të mbetjeve, duke ulur sasinë e mbetjeve që përfundojnë në landfill.**

Një tjetër objektiv i Bashkisë Kamëz është përmbushja e standardeve të BE-së në lidhje me menaxhimin e mbetjeve, duke kontribuar në integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian. Përmes strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe politikave që synojnë ndarjen në burim dhe riciklimin e materialeve, Bashkia Kamëz synon të kontribuojë në një ekonomi qarkulluese, ku mbetjet trajtohen si një burim për krijimin e vlerave të reja dhe për mbrojtjen e mjedisit.

5.6 Qëllimi dhe objektivat e PMIM Kamëz

Qëllimi universal i Planit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (PMIM) të Bashkisë Kamëz është të sigurojë një sistem të qëndrueshëm dhe efikas për menaxhimin e mbetjeve, që kontribuon në përmirësimin e kushteve të jetesës, ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit publik. Ky plan ka si objektiv integrimin e të gjitha proceseve të menaxhimit të mbetjeve, duke përfshirë mbledhjen, transportin, depozitimin, riciklimin dhe trajtimin e mbetjeve, në mënyrë që të sigurohet një sistem i qëndrueshëm, ekonomik dhe ekologjik për qytetarët e Kamëz.

Në përmbledhje, objektivat kryesore të PMIM janë:

1. **Përmirësimi i shërbimeve të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve:** Sigurimi i një shërbimi të rregullt dhe efikas për grumbullimin e mbetjeve nga qytetarët dhe transportimin e tyre në vendet e trajtimit, duke minimizuar vonesat dhe rritur cilësinë e shërbimit.
2. **Ndarja në burim dhe promovimi i riciklimit:** Inkurajimi i qytetarëve që të ndajnë mbetjet në burim (plastikë, letër, qelq, etj.), për të mundësuar riciklimin dhe uljen e sasive të mbetjeve që përfundojnë në landfill.
3. **Reduktimi i ndikimit mjedisor të mbetjeve:** Implementimi i zgjidhjeve që do të ndihmojnë në reduktimin e mbetjeve dhe minimizimin e ndikimit të tyre në mjedis, përfshirë mbrojtjen e burimeve natyrore dhe uljen e ndotjes.
4. **Edukimi dhe informimi i qytetarëve:** Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për rëndësinë e menaxhimit të duhur të mbetjeve dhe nxitja e bashkëpunimit të tyre për një mjedis më të pastër dhe të qëndrueshëm.
5. **Krijimi i mundësive për menaxhim efikas të mbetjeve:** Përdorimi i teknologjive të avancuara dhe metodave të trajtimit që përmirësojnë menaxhimin e mbetjeve dhe mundësojnë riciklimin e materialeve, uljen e mbetjeve që shkojnë në landfill dhe përmirësimin e efikasitetit të procesit.
6. **Sigurimi i një infrastrukture të përshtatshme:** Ndërtimi dhe përmirësimi i infrastrukturës për mbledhjen, grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve, duke siguruar që kjo infrastrukturë të jetë e qëndrueshme dhe në përputhje me standardet mjedisore.

Ky plan është krijuar për të siguruar që Bashkia Kamëz të menaxhojë mbetjet në një mënyrë të përgjegjshme, duke ndihmuar në ruajtjen e mjedisit, shëndetit të qytetarëve dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në komunitet.

Synimi kryesor i Bashkisë Kamëz në këtë plan është përmbushja e standarteve të kërkuara për menaxhimin e mbetjeve, duke u siguruar që të respektohen parimet kryesore dhe kërkesat

ligjore të planifikimit, që janë thelbësore për një menaxhim të qëndrueshëm dhe efikas. Ky synim përfshin disa aspekte të rëndësishme, të cilat janë:²⁷

1. **Përmbushja e standardeve dhe kërkesave ligjore:** Bashkia Kamëz do të punojë për të siguruar që menaxhimi i mbetjeve të jetë në përputhje me legjislacionin dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, duke garantuar një sistem të organizuar dhe të sigurt për mbledhjen, transportimin dhe trajtimin e mbetjeve.
2. **Mbuluarja e të gjithë territorit të aksesueshëm me shërbim:** Ky synim ka për qëllim zgjerimin e shërbimeve për mbledhjen e mbetjeve, për t'u siguruar që çdo qytetar të ketë akses në shërbimin e mbledhjes dhe menaxhimit të mbetjeve.
3. **Përmirësimi i situatës së financimit të shërbimit:** Për të mbështetur qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve, Bashkia Kamëz do të punojë për të përmirësuar financimin e këtyre shërbimeve, duke siguruar burime të mjaftueshme për realizimin e objektivave të planit dhe për mbështetje të infrastrukturës së nevojshme.
4. **Rritja e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes së komunitetit:** Një komponent i rëndësishëm është edukimi dhe angazhimi i qytetarëve për një menaxhim më të mirë të mbetjeve. Bashkia do të ndërmarrë fushata edukative dhe informuese për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe për t'i inkurajuar ata të kontribuojnë në ndarjen e mbetjeve, riciklimin dhe uljen e ndotjes. Pjesëmarrja aktive e komunitetit është thelbësore për suksesin e këtij plani.

Në përmbledhje, synimi i Bashkisë Kamëz është të krijojë një sistem të qëndrueshëm dhe efikas për menaxhimin e mbetjeve që plotëson kërkesat ligjore dhe standardet ndërkombëtare, duke siguruar një mjedis të pastër dhe shërbime cilësore për të gjithë qytetarët dhe vizitorët.

6 ASPEKTET FINANCIARE NË MENAXHIMIN E MBETJEVE URBANE

6.1 Kosto e plotë e menaxhimit të mbetjeve urbane

Përlllogaritja e kostove të menaxhimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Kamëz, është realizuar sipas modelit “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve” miratuar me VKM nr.319 datë 31.05.2018.

Këtu përfshihen të gjitha elementet e këtij shërbimi, të ndara në 7 blloqe përlllogaritjeje.

- 1-Të dhëna të përgjithshme për njësinë administrative.
- 2-Investimet kapitale.
- 3-Kostot operative (mirëmbajtje, transport dhe personel).
- 4-Kostot e amortizimit (ri-investimit).
- 5-Kostot administrative.
- 6-Përlllogaritja e kostove totale të shërbimit.

Proceset e punës jashtë kësaj metodologjie janë: Grumbullimi i PGM, fshirja manuale, mirëmbajtje e PGM-ve.

6.2 Grumbullimi i Mbetjeve

6.2.1 Volumet e punimeve

Në Bashkinë Kamëz ka një popullsi prej 150 101 banorë (sipas Regjistrit të Gjendjes Civile Bashkia Kamez). Referuar Vendimit nr. 538, datë 22.09.2021 “Për disa shtesa në vendimin nr.687, datë 29.7.2015, Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”, Bashkitë duhet të përdorin numrin e popullsisë për llogaritjet e sasisë së mbetjeve që gjenerojnë, sipas formulës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duke shmangur mospërputhjet që vijnë të dhënat e popullsisë sipas Regjistrit të Gjendjes Civile dhe Popullsisë së INSTAT-it (2023).

Popullsia= Popullsia (Census) + (Popullsia Regjistri Gjendjes Civile-Popullsia Censusi 2023) * 0.30

Zona në tërësinë e saj ka karakter urban dhe semi urban. Në total në zone gjenerohen afërsisht rreth **101 ton/ditë** mbetje të ngurta urbane, ose **36865 ton** mbetje të ngurta urbane gjatë gjithë viti, të cilat duhet të grumbullohen dhe transportohen në landfillin e Sharres çdo ditë të javës. Parashikimi i volumeve ka marrë në konsideratë përveç koeficientit për banor të parashikuar sipas VKM, edhe sasia e depozituar në landfill gjatë periudhës që administrohet nga bashkia. Kjo sasi mbetjesh do të mbledhet në terren nga **350** kontenierë me kapacitet 1,600 litra (1.6m³) të shtrirë në të gjithë Bashkinë, sipas **300** PGM.

Gjatësia totale e rrugës për grumbullimin e mbetjeve në territorin e qytetit të Kamzes është **480km**. Sipas planit të përcaktuar për vendosjen e pikave të grumbullimit të mbetjeve, distanca midis tyre varion nga 100-200m larg.

6.2.2 Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbimi i grumbullimit, të mbetjeve të ngurta urbane konsiston në:

- a. Zbrazjen e kontenierëve me makinën e përshtatshme teknologjike të përcaktuar.
- b. Mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura përreth në një distancë me rreze prej 5 m nga çdo kontenier.
- c. Pastrimin dhe fshirjen me fshesë të sipërfaqes prej 30 m² rreth çdo pike grumbullimi.
- d. Rivendosja e kontenierëve të sistemuar në vendin e caktuar. Kontenierët duhet të vendosen drejt, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike për mjedisin urban dhe me kapakë të mbyllur.
- e. Klorifikimi i zonës së kazanëvë, sipas normativave.

6.2.3 Frekuencat e grumbullimit


Në Bashkinë Kamëz shërbimi i grumbullimit të mbetjeve do të ofrohet çdo dite. Oraret e grumbullimit do të jenë natën, nga ora 20.00 deri në orën 06.00, turni parë dhe 12.00-17.00 turni dytë.

6.2.4 Plani i vendosjes së kontenierëve dhe grafikët e punimeve

Bashkia Kamëz ka përcaktuar pikat ekzakte të grumbullimit të mbetjeve të ngurta urbane, dhe numrit të kontenierëve për secilën pikë, në të gjithë zonën ku përfshihen edhe të gjitha pikat e grumbullimit



1.5 Mjetet dhe pajisjet

Lloji i mjetit	Mjet teknologjik transportues (kompaktor)
Ngarkimi fundor i makinës (kapaciteti i mjetit)	10ton/15ton 
Raporti i Kompaktimit	1:4 – 1:6
Kapja e mjetit në pjesën fundore	Duhet të jetë me krahë kapës për kontenierë me volum 1600 litra (1.6m ³) 
Rrotat e mjetit	Duhet të jenë rrota të mëdha të cilat të mund të lëvizin lirisht në territore malore dhe të mbuluara me borë
Marshi	Manual/ automatik
Klasa e shkarkimit	Sipas legjislacionit ne fuqi

<i>Nr</i>	<i>Lloj</i>	<i>Sasia/Copë</i>	<i>Kapaciteti m3</i>
1	Makina Teknologjike	3	20 - 23
2	Makina Teknologjike	4	10 - 12
3	Makina Teknologjike	2	8 - 10
7	Makinë fshirje mekanike	1	-

Të dhëna mbi mjetet që realizojnë shërbimin e pastrimit në Bashkinë Kamëz.

6.3 Personeli

Personeli i nevojshëm për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave është një shofer dhe tre puntorë për çdo makinë që grumbullon dhe transporton mbetjet.

Kushtet e punës për të gjithë stafin duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kështu stafi duhet të jetë i paisur me rrobat e përshtatshme të punës, me shenja dalluese që do të bëjnë të mundur identifikimin e tyre dhe gjatë natës, me doreza dhe paisje të tjera mbrojtëse për sigurimin teknik në punë.

- Punonjësit që realizojnë shërbimin e Pastrimit në Bashkinë Kamëz

6.6.1 Lista e rrugëve që lahen mekanikisht përgjat 6 muajve

Rruga “Demokracia” Paskuqan

Rruga "Besim Cera" + Rruga "Hajri Skeja"
Rruga "Arjan Sala"
Rruga "Demokracia" Bathore
Rruga "Skenderbeu"
Rruga "Berisha"
Rruga "NATO"
Rruga "Abdi Bej Toptani"
Rruga "Harku i Triumfit"
Rruga "Nënë Tereza"
Rruga "Abdyl Elmazi"
Rruga "Arben Broci"
Rruga "Ramush Haradinaj"
Rruga "Shen Gjon Pali"
Rruga "Donald Trump" + Rruga "Beslidhja"

7 PLANIFIKIMI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE

7.1 Vizioni

Vizioni i planit lokal të menaxhimit të mbetjeve të Bashkisë Kamëz u formëzua në sajë të një procesi të vazhdueshëm diskutimi dhe konsultimi midis palëve të interesuara të përfshira drejtpërdrejtë në përgatitjen e planit (Grupi i Punës dhe Përfaqësues të Bashkive të Forta), në sajë të analizimit gjendjes ekzistuese të ofrimit të shërbimit dhe propozimeve për konsolidimin e shërbimit në të gjithë territorin e bashkisë. Referuar statusit aktual të menaxhimit të mbetjeve, prioriteteve të përgjithshme dhe konkrete në kuadrin e ndarjes së re administrative si dhe pritshmërive për zhvillimin e këtij sektori, vlerave dhe normave qytetare, nevojës për ndryshim, dhe ruajtjes së burimeve natyrore u ra dakord që vizioni i bashkisë të jetë:

"Bashkia Kamëz, një bashki e pastër, me një zhvillim të qëndrueshëm mjedisor ku ofrohen shërbimet e menaxhimit të mbetjeve sipas standardeve më të larta në çdo njësi administrative në territorin e saj .

7.2 Objektivat

Bashkia Kamëz gjatë 5 vjeçarit të zbatimit të planit lokal për menaxhimin e mbetjeve kërkon mbi të gjitha të konsolidojë shërbimin në zonat ku aktualisht e ofron këtë shërbim, duke rritur gradualisht cilësinë e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve për në landfillin e Sharrës. Më tej ajo kërkon të fillojë të zbatojë skema për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve urbane, duke synuar mbylljen e ciklit të plotë të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Ky plan ka parashikuar hartimin e objektivave emergjente dhe objektiva afat gjatë:

7.2.1 Objektivat emergjente:

1. Plotësim i kuadrit ligjor dhe rregullator lokal për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane
 - Miratimi i planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve;
 - Hartimi i rregulloreve për shërbime të caktuara të mbetjeve, duke përcaktuar standardet minimale që duhen plotësuar;
2. Reduktimi depozitimeve ilegale të mbetjeve urbane dhe sidomos të mbetjeve voluminoze.

7.2.2 Objektiva afatgjatë:

3. Nxitja e iniciativave për minimizimin e mbetjeve përmes stimulimit të grumbullimit të ndarë dhe kompostimit.
 - Promovimi i ndarjes në dy rryma të mbetjeve urbane (të thata dhe të njoma) në lagjet kryesore të qytetit të Kamëz;
 - Promovimi i skemave të kompostimit të mbetjeve në Lagjen Administrative Laknas-Valias
 - Shtrirja e skemave të kompostimit edhe në njëstë e tjera administrative me karakter rural.
4. Forcimi i kuadrit financiar të manaxhimit të mbetjeve, duke konsoliduar mekanizimin e hartimit të buxhetit për shërbimet e mbetjeve dhe hartimin e marrëveshjeve dhe kontratave bazuar në standardet e paracaktuara në rregulloret përkatëse të shërbimit.
5. Sensibilizimi i komunitetit dhe bizneseve për t'u bërë pjesë e iniciativave të bashkisë për mbajtjen pastër të territorit si dhe për aplikimin e skemave inovative për minimizimin e mbetjeve.

7.2.3 Rryma e mbetjeve, objekti i planit

Sipas legjislacionit në fuqi, ky plan do të fokusohet në rrymën e mbetjeve bashkiake (urbane) për të cilën Bashkia Kamëz është drejtpërdrejt apo pjesërisht përgjegjëse:

Sipas përbërjes dhe mënyrës së manaxhimit të mbetjeve, mbetjet bashkiake do të klasifikohen në:

- Mbetje urbane (mbetje shtëpiake, ushqime, bimë, të riciklueshme, të dekompozuar, etj.), dhe
- Mbetje të veçanta urbane (mbetje ndërtimet dhe prishjet, voluminoze, pajisje elektrike dhe mobiljesh, etj.) që prodhohen nga familjet apo njësitë tregtare;

- Mbetje të rrezikshme që prodhohen brenda territorit të bashkisë nga banorë të përhershëm apo të përkohshëm.

Sipas burimit të gjenerimit mbetjet urbane (bashkiake) klasifikohen në dy rryma:

- Mbetjet e gjeneruara nga familjet (MF)
- Mbetjet e gjeneruara nga bizneset dhe industritë (MB), ku përbërja e mbetjeve nuk ndryshon nga karakteristikat e mbetjeve urbane

Ndërkohë, rryma të tjera të mbetjeve klasifikohen si mbetje masive, mbetje nga ndërtimet dhe prishjet (inerte), mbetje nga kopshtet që prodhohen në familje dhe që quhen ‘mbetje të veçanta’ për të cilat njësia vendore duhet t’i ofrojë e vetme ose në bashkëpunim alternativa të përshtatshme për grumbullimin dhe transportin e tyre, megjithëse largimi i tyre është përgjegjësi direkte e prodhuesit.

7.3 Shërbimet e menaxhimit të mbetjeve

Në këtë plan 5 vjeçar, Bashkia Kamëz parashikon tre shërbime kryesore të menaxhimit të mbetjeve, të cilat konsistojnë në:

- i) Shërbimi i pastrimit të rrugëve;
- ii) Shërbimi i grumbullimit, transportit i mbetjeve;
- iii) Depozitimi i mbetjeve në landfillin e Sharrës;
- iv) Shërbimi i minimizimit të mbetjeve.

● Shërbimet e pastrimit të rrugëve

Organizimi i shërbimeve të pastrimit duhet të marrë në konsideratë nevojat për pastrimin e rrugëve dhe shkallën e ndotjes ditore nga mbetjet dhe hedhurinat, apo brenda një periudhe të caktuar ditësh. Për këtë qëllim propozimi i frekuencave për secilën kategori rrugësh duhet të jetë objekt i një vlerësimi apo testi deri në përcaktimin përfundimtar në specifikime teknike të mundshme në rast se ky shërbim do të kontraktohet në të ardhmen.

Një element shumë i rëndësishëm në organizimin e shërbimeve të pastrimit të rrugëve është edhe kategorizimi i rrugëve në funksion të rëndësisë si më poshtë:

1. **Kategoria e Parë:** (përfshin rrugët kryesore dhe rrugët tregtare) nevojitet shërbimi ditor i fshirjes; është më i parapëlqyer pastrimi me makinë teknologjike i akseve kryesore (kur është e mundshme dhe ka efektivitet), por dhe mirëmbajtja e tyre gjatë ditës, vendosja dhe pastrimi ditor i koshave rrugore, si dhe shërbim i larjes gjatë verës, i cili mund të kombinohet me makinën teknologjike që kryen edhe fshirjen edhe larjen;
2. **Kategoria e dytë:** (rrugët kryesore me aktivitet të ulët komercial dhe me densitet të ulët kalimtar) fshirja manuale e rrugëve është e nevojshme të kryhet çdo ditë të javës.
3. **Kategoria e tretë:** (sistem rrugor periferik në zona me dendësi të ulët urbane, apo në zona me infrastrukturë jo të rregullt dhe rrugë të paasfaltuara) është i nevojshëm një shërbim mujor

pastrimi (fshirje ose thjesht mbledhje mbetjesh dhe hedhurinash).

Bashkia Kamëz, aktualisht ofron shërbimin e fshirjes së rrugëve kryesore në qytetin e Kamzës, ku gjatë turnit të natës punëtorët fshijnë rrugët dhe gjatë paradites bëhet mirëmbajtja e pikave të grumbullimit të mbetjeve apo fshirja e ndonjë hedhurine në rrugë. Ky shërbim ofrohet çdo ditë me dy turne, dhe bashkia kërkon ta mbajë këtë standard edhe gjatë 5 viteve të ardhshme.

Bashkia synon të rrisë cilësinë e këtij shërbimi, duke filluar shërbimin e fshirjes dhe larjes mekanike në rrugët kryesore të qytetit me një mjet specifik për fshirjen mekanike, i cili do të ketë të angazhuar vetëm 1 shofer. Ky shërbim do të ofrohet dy herë në javë dhe gjatë një turni ditor mjeti do të fshijë 343,077m²/ditë.

1.4 *Grumbullimi, transporti i mbetjeve*

Në parashikimin e shërbimeve të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve Bashkia duhet të marrë në konsideratë parimin për parandalimin e ndotjes. Cilësia dhe kostot e shërbimit të mbledhjes dhe largimit të mbetjeve urbane lidhen drejtpërdrejtë me mënyrën se si konsumatorët hedhin mbetjet, përdorin PGM, respektojnë oraret e përcaktuara dhe zbatojnë rregullat lokale për manaxhimin e mbetjeve. Në këtë aspekt, bashkia duhet të plotësojë kuadrin e saj rregullaror në sajë të:


Hartimit të një rregulloreje vendore për manaxhimin e mbetjeve, ku do të përcaktohen procedurat, protokollet e punës, parashikimet se çfarë do të ndodh në rast avarish apo aksidentesh në punë, të drejtat dhe detyrimet e të gjitha grupeve të interesit të përfshira në menaxhimin e mbetjeve si dhe gjohet përkatëse në rast të shkeljeve të evidentuara. Si parakusht, bashkia duhet të caktojë një grup pune për monitorimin dhe për të vënë në zbatim këto rregulla;

- Parandalimin e hedhjes së paligjshme dhe derdhjen e mbetjeve jashtë kontenierëve gjë që duhet të sjellë në vëmendje rëndësinë kryesore që kanë fushatat e ndërgjegjësimit dhe programet e edukimit;
- Marrëveshje me konsumatorët e mëdhenj, për të përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrimet e secilës palë, ku rekomandohet vendosja e orareve në ditë dhe orë të caktuara për dorëzimin e mbetjeve nga konsumatori në pikat e caktuar nga bashkia, ose grumbullimi i tyre nga bashkia, në sajë të një kontrate të veçantë, në pikat e gjenerimit të tyre.

Ndërkohë elemente të tjerë që kanë të bëjnë me shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve, që bashkia duhet të marrë në konsideratë gjatë planifikimit të shërbimit në territorin e saj, janë si më poshtë:

- a) **Orare pune efektive dhe të përshtatshme:** Për të operuar sipas nevojave të pastërtisë dhe në mënyrë të efektshme dhe me kosto të ulët, bashkia duhet të hartojë një program efektiv dhe të përshtatshëm pune. Ky program duhet të marrë parasysh ndryshimet ditore, javore dhe mujore në lidhje me numrin e banorëve dhe veprimtarive tregtare.
- b) **Numri i duhur i kontenierëve:** Për të ofruar një shërbim të efektshëm dhe me kosto të ulët,

- b) **Numri i duhur i kontenierëve:** Për të ofruar një shërbim të efektshëm dhe me kosto të ulët, bashkia duhet të sigurojë numrin e duhur të kontenierëve apo koshave dhe rregullsinë e mbledhjes së mbetjeve.
- c) **Itenerar efektiv për mbledhjen e mbetjeve:** Përcaktimi i saktë i itenerarit për makinat e mbetjeve do të ulë koston duke pakësuar forcat që shpenzohen për mbledhjen e mbetjeve. Rekomandohet verifikimi i përputhshmërisë me parimet e efektshmërisë së itenerarit të grumbullimit të mbetjeve si dhe të kohës efektive me metodën (MTM – Metodës të Matjes së Kohës).
- d) **Rritja e rendimentit në punë:** Bashkia duhet të gjejnë mekanizma për të përmirësuar punën duke rritur rendimentin. Masat që mund të ndërmerren për të rritur moralin, përfshijnë përmirësimin e kushteve të përgjithshme të punës, pajisja me uniformë, stimujt për punë të mirë, trajnimi dhe forcimi i punës në grup.
- e) **Mirëmbajtja e përshtatshme e kontenierëve dhe makinave të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve:** Mirëmbajtja dhe riparimi i specializuar i makinave dhe pajisjeve janë çështje të rëndësishme për shërbimin e mbledhjes së mbetjeve. Pavarësisht nëse shërbimi ofrohet nga bashkia apo kontraktohet një kompani private, bashkia duhet të përcaktojë ose parashikojë në kontratë mirëmbajtjen e duhur dhe standardet e riparimit që duhet të vihen



në zbatim.

Skema e grumbullimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Kamëz.

Referuar gjëndjes aktuale të shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve si dhe eksperiencës, arritjeve dhe problematikës të identifikuar në kapitujt e mëparshëm të këtij plani, nënvizojmë se shërbimi i ofruar në Bashkinë Kamëz aktualisht është në gjendje shumë të mirë në raport me shërbimin e ofruar më parë nga operatori ekonomik këncensionar.

Sipas ligjit për vetqeverisjen vendore kanë si funksion shërbimet e menaxhimit të mbetjeve (grumbullim, transport dhe trajtim final të tyre). Në këtë llogjikë, rekomandohet që autoritetet vendore të rehabilitojnë vend-depozitimet e pakontrolluara dhe të parashikojnë depozitimin e mbetjeve në landfillet rajonale të ardhshme apo ato ekzistuese në qarqet përkatëse. Bashkia Kamëz ka një akt-marrëveshje me Shoqërinë “INTEGRATED ENERGY BV SPV” e nënshkruar me **ADMINISTRATORIN SHTETËROR**, “Për depozitim të mbetjeve urbane në Zonën e Trajtimit të Mbetjeve Tiranë” sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Mbetjet Urbane të Bashkisë Kamëz, depozitohen sipas akt-marrëveshjes së sipërcituar në Zonën e Trajtimit të Mbetjeve Tiranë që është dhe zona e përcaktuar për depozitimin e mbetjeve urbane për Bashkitë e Qarkut Tiranë.

7.5 Minimizimi i mbetjeve

Sistemi parësor – skemat individuale të ndarjes së mbetjeve: Sistemi i mbledhjes individuale nga familjet dhe bizneset përbën bazën për ngritjen e sistemit të ndarjes së mbetjeve. Duhet thesuar se sistemi i ndarjes në burim duket më i preferueshëm sesa sistemi i ndarjes së mbetjeve në rrugë. Nga këndvështrimi i angazhimit të drejtpërdrejtë të pronarëve apo personave të kontaktit të bizneseve apo familjeve, ky sistem siguron më shumë ndërgjegjshmëri, efektivitet dhe mundësi financimi sesa sistemi i hapur mbi të cilin mbështetet skema e përbashkët.

Ndarja në burim mund të jetë më praktike dhe e efektshme për biznesin dhe industrinë, ku duhet të mundësohet shërbimi individual i grumbullimit të mbetjeve. Koshat për ndarjen e mbetjeve në burim mund të vendosen në çdo njësi të madhe biznesi apo institucion shtetëror duke ndjekur të njëjtën teknologji si sistemi i mbledhjes individuale. Sistemi duhet të jetë sa më i thjeshtë duke synuar vetëm ato mbetje apo komponentë që mund të riciklohen. Për këtë arsye, sistemi me katër kontenierë të vegjël duket më i favorshëm se të tjerët. Kjo nënkupton caktimin e një kodi me ngjyra për alternativën me katër kontenierë që konsumatorët ta kenë parasysh, kur vendosin të depozitojnë mbetjet aty.

Sistemi dytësor – skemat e përbashkëta për ndarjen e mbetjeve: Përdorimi i sistemit aktual të grumbullimit të mbetjeve urbane shërben si një bazë për të vënë në funksionim dhe prezantuar sistemin e mbledhjes së diferencuar të tyre. Kjo mënyrë mund të jetë praktike vetëm kur qytetarët dhe bizneset janë mësuar me këtë lloj sistemi dhe do të mund të përshtaten më mirë. Kjo metodë është e preferueshme kryesisht në qytete të mëdha ku është i pamundur krijimi i sistemeve individuale për ndarjen e mbetjeve dhe blloqet e banimit janë kolektive.

Sektori informal, i cili është krahu kryesor i punës në sektorin e grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme nuk është plotësisht në vëmendje nga strukturat shtetërore. Ky sektor sjell mjaft dobi në sektorin e menaxhimit të mbetjeve, si: i) ul mesatarisht deri 15-30% sasinë e mbetjeve që depozitohen në landfill/fushë depozitimi; ii) Ul koston e shërbimit të grumbullimit dhe transportit

të mbetjeve; iii) Është burim të ardhurash për rreth 2% të popullsisë së zonave të varfra; iv) Sipas shifrave nga literatura e huaj llogaritet që çdo ton mbetje e riciklueshme e grumbulluar është e barabartë me një vend pune.

Ashtu si hierarkia e përgjithshme e menaxhimit të mbetjeve, edhe menaxhimi i mbetjeve të riciklueshme duhet të mbështetet në një hierarki të ngjashme, ku objektivi kryesor është parandalimi sa më shumë i gjenerimit të mbetjeve:

- i. Riprodhimi i mbetjeve të riciklueshme (prioritarizohet më shumë)
- ii. Grumbullimi i mbetjeve të riciklueshme nga tregtarët
- iii. Mbledhësit formalë të mbetjeve të riciklueshme
- iv. Grumbulluesit fillestarë të mbetjeve të riciklueshme
- v. Mbledhësit informalë të mbetjeve të riciklueshme (prioritarizohet më pak)

8 KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

8.1 Rregullorja vendore

Bashkia e Kamzës duhet të përgatisë dhe miratojë rregulloren lokale për administrimin e shërbimit të mbetjeve, ku të përcaktohet qartë rolin dhe përgjegjësia e prodhuesve dhe operatorëve të mbetjeve, me qëllim administrimin e suksesshëm të tyre brenda territorit të saj administrativ. Kjo rregullore duhet të përcaktojë rregullat dhe procedurat për administrimin vendor të mbetjeve, procedurat për trajtimin e ankesave të qytetarëve si dhe gamën e sanksioneve për mosrespektim të rregullave.

Më konkretisht kjo rregullore duhet të përfshijë:

- a. Standardet lokale të punës dhe cilësisë, metodologjitë dhe teknologjitë, rregullat e sigurisë dhe të shëndetit për shërbimet e pastrimit dhe të administrimit të mbetjeve;
- b. Rregullat dhe detyrimet e prodhuesve të mbetjeve;
- c. Sanksione në raste të dëmtimit të kontenierëve, të ndryshimit të funksionit apo vendodhjes së PGM apo kontenierëve;
- d. Marrjen e masave parandaluese për mosdjegien e mbetjeve në kazanë, për moshedhjen e mbetjeve në rrymat ujore dhe kanalizimet, apo në vende të tjera nga ato të miratuara nga bashkia;
- e. Marrjen e masave parandaluese për moshedhjen e mbetjeve voluminoze dhe atyre të rrezikshme, mosdepozitimin e kafshëve të ngordhura dhe mbetjeve të rrezikshme në PGM të mbetjeve urbane;
- f. Shmangien e parkimit të automjeteve përballë apo pranë pikave të caktuara të grumbullimit të mbetjeve;
- g. Marrjen e masave për pastrimin nga ana e pronarëve të hapësirave rreth dyqaneve dhe pikave ambulatorie të shitjes;
- h. Marrjen e masave për sigurimin e një pastërtie të pranueshme duke dezinfektuar kontenierët dhe koshat rrugore të depozitimit të mbetjeve;
- i. Mbajtja e uniformave gjatë proceseve të punës nga punonjësit e pastrimit;
- j. Përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të administruesve të mbetjeve (operatorët e mbetjeve, industria e mbetjeve):
 - Veprimet të kryhen vetëm nga kontraktorë të licencuar;
 - Procedurat administrative për dhënien dhe heqjen e licencave;
 - Pagesa e tarifave dhe taksave të vendosura nga autoriteti vendor;
 - Përdorimi i makinerive dhe kontenierëve të përshtatshëm;
 - Përdorim i vendeve të licensuara të depozitimit;

8.2 Zbatimi dhe sanksionet

Rregullorja vendore e administrimit të mbetjeve shoqërohet me një sërë gjobash dhe sanksionet që duhet të caktohen dhe miratohen nga Këshilli Bashkiak. Niveli i gjobave dhe sanksioneve duhet të bazohen në shërbimin e ofruar dhe në parimin “ndotësi paguan”, ku shkelësi duhet të ndëshkohet me qëllim që të merren parasysh kostot e pastrimit apo mbledhjes së mbetjeve, kostot mjedisore dhe për më tepër të krijohet një sistem i drejtë për dekurajimin dhe parandalimin e ndotësve.

Gjjobat lokale duhet të vendosen nga inspektorët bashkiakë që janë nën juridiksionin e bashkisë. Përgjegjësia kryesore e këtyre inspektorëve është të vendosin sanksione për personat fizikë apo juridikë që shkelin kushtet ligjore në lidhje me mbledhjen, largimin dhe transportin e mbetjeve.

8.3 Ndërgjegjësimi publik

Për të siguruar mirëfunksionimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve, rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve si dhe sigurimin e pastërtisë në nivele të kërkuara në territorin e bashkisë, është shumë i domosdoshëm përfshirja dhe ndërgjegjësimi i komunitetit. Komuniteti jo vetëm duhet të kuptojë funksionimin e sistemit, por duhet ta mbështesë atë. Suksesi i çdo skeme menaxhimi mbetjesh bazohet plotësisht nga mbështetja e përdoruesve. Konsumatorët si familjet, bizneset apo institucionet, në sajë të një fushatë të fortë ndërgjegjësimi mund të ndikojnë në përmirësimin e sistemit të grumbullimit, duke zbatuar kërkesat e hedhjes dhe ndarjes së mbetjeve dhe duke penguar materialet e padëshirueshme (psh. mbetjet e rrezikshme), të hyjnë në rrymën e mbetjeve të grumbulluara. Ndërgjegjësimi publik ndaj çështjeve të mbetjeve dhe nivelit të pastërtisë, konsiderohet si një prioritet dhe objektiv primar krahas objektivave të tjerë që lidhen me infrastrukturën apo me depozitimin e sigurtë të mbetjeve. Ka disa mënyrë për të rritur ndërgjegjësimin publik për çështjet e mbetjeve dhe për të dhënë informacion se si mund të trajtohen ato, me një kosto relativisht të ulët, por mjaft efektive për arritjen e objektivit.

Hartimi i një plani ndërgjegjësimi do të mundësojë: i) ofrimin e një informacioni të përgjithshëm dhe të veçantë për publikun në lidhje me nismat vendore të mbledhjes, riciklimit të mbetjeve, pastërtisë së territorit dhe kostos së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve; ii) ndërgjegjësimin e publikut për detyrimet ligjore, rregullat dhe detyrimet vendore; iii) nxitjen e qëndrimit miqësor ndaj mjedisit.

Metoda për komunikimin dhe informimin: Metodatat më të përdorura të komunikimit të informacionit janë broshurat, artikujt në gazeta, njoftimet, dhe reklamat në TV dhe radio lokale, dhe fletëpalosje që shpërndahen në shkolla. Një zhvillim të lartë sot në vend ka edhe teknologjia e informacionit si edhe aksesin në internet. Kjo teknologji si edhe tërheqja pas rrjeteve sociale të komunitetit (kryesisht atij në moshë të re) mund të jetë një mundësi e mirë për komunikimin dhe informimin e publikut për shkak edhe të kostos së ulët si edhe shpejtësisë që ofron.

Gjithashtu mund të shfrytëzohen dhe evente të karaktereve të ndryshme (festa, tubime,

koncerte), ku ka grumbullime të mëdha njerëzish dhe ku informimi dhe komunikimi me publikun bëhet më i lehtë.

Në programet e riciklimit apo minimizimit të mbetjeve metoda më e mirë është ajo “derë më derë”. Kjo metodë fton konsumatorët në nismat e riciklimit dhe kompostimit, për të përmirësuar qëndrimin e tyre ndaj ndarjes së mbetjeve në burim, për të zbatuar rregullat dhe respektuar oraret. Banorëve dhe bizneseve iu shpërndahen fletë informative për llojet e mbetjeve që mund të riciklohen, kompostohen dhe mënyrën se si ato duhet të veprojnë për t’u bërë pjesë e procesit.

Përdorimi i makinave teknologjike që shërbejnë për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve apo kontenierët për informim: Tek të gjithë makinat dhe nëse është e mundur tek kontenierët e mbetjeve duhet të shkruhet qartë dhe lehtësisht e lexueshme një slogane domethënëse për të mbajtur pastër zonën, numrin e telefonit të ofruesit të shërbimit si dhe numrin e telefonit falas që caktohet nga autoritetet vendore, sipas një formati të miratuar paraprakisht.

8.3.1 Model për hartimin e një fushatë informimi për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve dhe skemave për minimizimin e tyre.

Ky program, do t’iu vijë në ndihmë jo vetëm komunitetit, i cili do të njihet me skemat e reja dhe iniciativat pilot të riciklimit dhe kompostimit, por edhe nxënësve të shkollave, të cilët do të marrin iniciativën për t’u njohur me skemat e menaxhimit të mbetjeve dhe do të jenë pjesë e procesit të riciklimit dhe kompostimit, në nivel komuniteti apo në ambjentet e shkollave. Objektivat potencialë të një fushate ndërgjegjesimi dhe informimi mund të formulohen nga bashkia si më poshtë:

1. Ndërgjegjësimin dhe informimin e qytetarëve në të gjithë zonën e parashikuar në lidhje me skemat e reja të menaxhimit të mbetjeve, si do të kryhen, si dhe angazhimin e tyre konkret në aplikimin e tyre;
2. Ndërgjegjësimin dhe rritja e numrit të qytetarëve që paguajnë tarifën për shërbimet e mbetjeve;
3. Mbështetje në aplikimin e skemave nxitëse për tarifa më të ulta të mbetjeve në sajë të angazhimit të komunitetit në aplikimin e skemave të riciklimit dhe kompostimit, duke përmirësuar në këtë mënyrë edhe shërbimin dhe cilësinë e mjedisit;
4. Rritja e numrit të qytetarëve dhe nr. nxënësve të shkollave të informuar në lidhje me procesin e minimizimit të mbetjeve (riciklim apo kompostim) dhe njëkohësisht që janë gati të ndërmarrin iniciativën për riciklimin e mbetjeve, si plastika, alumini, letra apo fillimin e skemave të kompostimit në zonat rurale;
5. Ndërgjegjësimin dhe informimin e qytetarëve në të gjithë zonën e parashikuar në lidhje me procesin se si do të kryhet riciklimi dhe kompostimi, si dhe angazhimi i tyre konkret në aplikimin e skemave;
6. Prezantimin e skemave të ndryshme të minimizimit të mbetjeve për kategori të ndryshme të qytetarëve dhe aktorëve që do të përfshihen në këtë iniciativë;

7. Prezantimin e modeleve/metodave që do të ndihmojnë në informimin dhe trajnimin e aktorëve të interesuar në aplikimin konkret të riciklimit dhe kompostimit të mbetjeve;
8. Prezantimin e skemave nxitëse për rritjen e pjesëmarrjes të aktorëve që do të aplikojnë skemat e minimizimit të mbetjeve;
9. Promovimi i mbrojtjes së mjedisit urban dhe rural.

Fushata ndërgjegjësuere dhe komunikuese do të jetë pjesë e programit të bashkisë, ku ajo do të marrë përsipër zbatimin e saj në të gjithë territorin e saj. Me anë të këtij programi bashkia duhet të synojë që periodikisht (ashtu siç është përcaktuar edhe në hapat më poshtë) gjatë gjithë vitit, të zhvillojë fushata intensive ndërgjegjësimi dhe informimi për komunitetin dhe specifiku për nxënësit e shkollave. Bashkia duhet të sigurojë burimet e nevojshme financiare dhe njerëzore për të realizuar periodikisht gjatë vitit këtë program. Në lidhje me burimet financiare bashkia duhet të parashikojë si fillim në buxhetin e saj një zë të veçantë për programin e ndërgjegjësimi dhe informimit, ku duhet të merret në konsideratë elementet si më poshtë:

1

1. Përgatitja e materialeve informuese, si kalendari periodik i fushateve ndërgjegjësuere, si broshura, postera apo stenda për në ambientet e bashkisë, shkollave apo zonave të ndryshme të qytetit

2

1. Përgatitja e spoteve publitare informuese për fushatat intensive periodike gjatë vitit kalendarik

3

1. Hedhja e informacioneve informuese në faqen e internetit të bashkisë dhe shpërndarja e informacionit në rrjete sociale

4

1. Përfshirja e ekspertëve/trajnuerëve të jashtëm që do të kryejnë sesionet e trajnimit në shkollat dhe në komunitet

5

1. Përgatitja dhe printimi i materialeve trajnuese për shkollat dhe komunitetin

Elementet e fushatës të ndërgjegjësimi dhe informimit

9 PLAN VEPRIMI

8.1 Komponenti: Kuadri ligjor dhe institucional					
1	Objektivi Strategjik	Veprimet e detajuara		Roli drejtues dhe Partnerët e tjerë	Afatet kohore
1.1	Përgatitja e kuadrit ligjor dhe rregullator lokal të menaxhimit të mbetjeve në përputhje me kërkesat në nivel kombëtar	1.1.1	Miratimi i Planit Lokal të Manaxhimit të Integruar të Mbetjeve Ngurta Bashkiakë;	Bashkia Kamëz; Këshilli Bashkiak	2025-2030
		1.1.2	Përditësimi i Rregullores Lokale të Manaxhimit të Mbetjeve në kushtet e ndarjes së re administrative;	Bashkia Kamëz (Dr. Juridike, Ndërmarrja e Pastrimit, Këshilli Bashkiak)	2025-2030
		1.1.3	Aprovimi i sanksioneve lokale dhe penaliteteve për çështjet e mbetjeve;	Bashkia Kamëz, Këshilli i Bashkiak	2025
		1.1.4	Aplikimi i instrumentave të komunikimit dhe informimit të komunitetit rreth rregullave dhe penaliteteve;	Bashkia Kamëz, (Ndërmarrja e Pastrimit), Vullnetarët, OJQ, përfaqësues të komunitetit,	2025-2030
1.2	Parandalimi i ndotjes nga gjenerimi dhe depozitimi pa kriter i mbetjeve të rrezikshme (si dhe spitalore) në zbatim të legjislationit shqiptar	1.2.1	Informimi i komunitetit për të diferencuar mbetjet e rrezikshme nga mbetjet urbane si dhe detyrimet e tjera të prodhuesit të mbetjeve;	Bashkia Kamëz, (Administratorët e NJA, Ndërmarrja e Pastrimit), Shkollat, ARM, Donatorët dhe organizatat -joqeveritare	2025-2030
		1.2.2	Krijimi i skemave efektive për grumbullimin e ndarë të mbetjeve të rrezikshme (të ngjashme me skemat e redukimit të mbetjeve);	Bashkia Kamëz, (Ndërmarrja e Pastrimit); organizatat -joqeveritare	2025-2030
1.3	Parandalimi i ndotjes nga gjenerimi i mbetjeve spitalore apo mbetjeve inerte dhe ndërtimore	1.3.1	Inspektimi dhe kontrolli i ndotjes urbane nga materialet inerte dhe ndërtimore, skeletet e makinave, etj, që nga gjenerimi, transporti deri depozitimin e tyre;	Bashkia Kamëz, (Administratorët e NJA, Ndërmarrja e Pastrimit & inspektorët bashkiakë),	2025-2030
		1.3.3	Organizimi i tryezave lokale me industrinë e ndërtimit për të	Bashkia Kamëz, (Administratorët e NJA,	2025-2030

			inkurajuar përdorimin dhe riciklimin e këtyre materialeve;		Ndërmarrja e Pastrimit); Industria e ndërtimit
1.4 Forcimi i kooperimit ndër-institucional dhe për monitorimin mjedisor dhe koordinimin e masave për përmirësimin e tij	1.4.1	Krijimi i dhe miratimi i një strukture lokale të inspektorëve bashkiak në lidhje me mjedisin dhe mbetjet;	Bashkia Kamëz, Këshilli Bashkiak	2025-2030	
	1.4.2	Zbatimi i sistemit të monitorimit në të gjitha NJA të Bashkisë dhe aplikimi i sanksioneve kundrejt shkelësve të rregullave apo dëmtuesve;	Bashkia Kamëz	2025-2030	

8.2 Komponenti: Grumbullimi dhe Transportimi i Mbetjeve dhe Pastrimi i Rrugëve				
2	Objektivi Strategjik	Veprimet e detajuara	Roli drejtues dhe Partnerët e tjerë	Afatet kohore
	2.1.5	Prezantimi i skemave të ndarjes në burim në rrugët kryesore të qytetit dhe në shkollat 9 vjeçare dhe të mesme të qytetit (mbetje të njoma dhe të thata);	Ndërmarrja e Pastrimit Kamëz	2025-2030
	2.1.6	Aplikimi i infrastrukturës të përshtatshme për grumbullimin e ndarë të mbetjeve të riciklueshme. Investim në kontenerë dhe mjete teknologjike të posaçme për grumbullimin e këtyre mbetjeve;	Ndërmarrja e Pastrimit Kamëz	2025-2030
	2.1.9	Aplikimi i infrastrukturës të përshtatshme për grumbullimin e ndarë të mbetjeve të të biodegradueshme. Investim në kontenerë dhe mjete teknologjike të posaçme për grumbullimin e këtyre mbetjeve;	Ndërmarrja e Pastrimit Kamëz	2025-2030
	2.1.11	Me anë të mjeteve të informimit dhe komunikimit të bëhen transparent për publikun kostot e shërbimeve të pastrimit sipas kontratave si dhe detyrimet, ndallimet, rregullat si dhe një informacion specifik rreth shërbimeve, orareve, iniciativave, etj.	Ndërmarrja e Pastrimit Kamëz	2025-2030

8.3 Komponenti: Depozitimi dhe Trajtimi i Mbetjeve				
3	Objektivi Strategjik	Veprimet e detajuara	Roli drejtues dhe Partnerët e tjerë	Afatet kohore
3.1	Rehabilitimi i të gjitha vend depozitimeve të	Kryerja e një studimi fizibiliteti për rehabilitimin dhe mbylljen e vendgrumbullimeve në NJA;	Ndërmarrja e Pastrimit Kamëz	2025-2026

vjetra në të gjitha NJA të Bashkisë Shkodër;	3.1.4	Hartimi dhe miratimi i një plani mjedisor të monitorimit dhe kujdesi pas mbylljes.	Ndërmarrja e Pastrimit Kamëz	2025-2030
	3.2.2	Monitorimi i rregullt i të gjitha dërgesave të mbeetjeve që hyjnë në landfill, kontrolli i ngarkesës në lidhje me kategorinë e mbeetjeve që duhet të lejohet të hyjë në landfill, raportimi i rregullt i ngarkesave të mbeetjeve që hyjnë në landfill.	Ndërmarrja e Pastrimit Kamëz	2025-2030

8.4 Komponenti: Ndarrja dhe Riciklimi i mbeetjeve

4	Objektivi Strategjik	Veprimet e detajuara		Roli drejtues dhe Partnerët e tjerë	Afatet kohore
4.1	Promovimi i ndarjes minimale të mbeetjeve në burim si dhe në të gjitha statet e gjenerimit të tyre duke aplikuar skema përshtatshme pilot; Progresi drejt objektivave kombëtarë për minimizimin e mbeetjeve në nivel lokal.	4.1.1	Mobilizimi i përfshirjes së komunitetit në skemat pilot, bërija e anketimeve paraprake për vlerësimin e vullnetit për t'u përfshirë para se të përgjigdhën zonat e dëshiruara;	Bashkia Kamëz, OJF, Komuniteti, vullnetarë,	2025-2030
		4.1.2	Hartimi i një plani-pune specifik për zbatimin e skemave të ndarjes së mbeetjeve, i cili duhet të koordinohet me sistemin ekzistues të grumbullimit të mbeetjeve të tjera urbane;	Ndërmarrja e Pastrimit Kamëz	2025-2030
		4.1.3	Krijimi dhe zbatimi i skemave pilot të riciklimit dhe kompostimit të shtëpi sipas skemave pilot të rekomanduara në këtë plan;	Ndërmarrja e Pastrimit Kamëz, Ekspertë & Konsulentë të jashtëm; biznese të riciklimit, Komuniteti	2025-2030
		4.1.4	Organizimi i takimeve në komunitet dhe me biznese, para dhe gjatë fillimit të skemave pilot për të mbështetur përpjekjet/programet e ndërgjegjësimit dhe edukimit për rritur cilësinë dhe nivelin e përfshirjes së komunitetit;	Ndërmarrja e Pastrimit Kamëz, Ekspertë & Konsulentë të jashtëm; biznese të riciklimit, Komuniteti	2025-2030
		4.1.5	Organizimi i takimeve me grupet e interesit në rajon dhe me gjerë. Reklamimi i faciliteteve ricikluese si dhe skemave të grumbullimit të diferencuar, skemave të kompostimit;	Ndërmarrja e Pastrimit Kamëz, Ekspertë & Konsulentë të jashtëm; biznese të riciklimit, Shoqata e Bashkive	2025-2030
		4.1.6	Monitorimi i zbatimit të skemave të ndarjes së mbeetjeve, riciklimit dhe kompostimit: efektiviteti dhe cilësisë së funksionimit ashtu dhe sasisë së mbeetjeve që ndahet dhe përpunohet; Mbajtja e një regjistri javor për këto të dhëna dhe relativimi çdo muaj pranë grupit mbikqyrës në bashki;	Ndërmarrja e Pastrimit Kamëz, Ekspertë & Konsulentë të jashtëm; biznese të riciklimit	2025-2030

4.2	Stimulimi mbështetja e sektorit lidhur me aktivitetet e riciklimit dhe kompostimit	4.1.7	Lidhja e marrvëshjeve bashkëpunimi/pjesëmarrje me bizneset e mëdhenj ashtu dhe nëse është e mundur me komunitetin e skemave pilot për detyrimet dhe përfitimet e palëve;	Ndërmarrja e Pastrimit Kamëz, Ekspertë, bizneset e mëdhenj të qytetit, konsumatorët e skemave pilot	2025-2030
		4.2.1	Inkurajimi i shtrirjes së skemave të riciklimit dhe kompostimit në shtëpi përmes bashkë-financimit me bizneset e riciklimit dhe komunitetin;	Ndërmarrja e Pastrimit Kamëz, Ekspertë & Konsulentë të jashtëm; biznese të riciklimit në rajon	2025-2030
		4.2.2	Promovimi dhe zhvillimi i tregjeve lokale për materialet e riciklueshme.	Ndërmarrja e Pastrimit Kamëz, Ekspertë të jashtëm; biznese të riciklimit në rajon	2025-2030

8.5 Komponenti: Aspektet Financiare				Roli drejtues dhe Partnerët e tjerë		Afatet kohore
5	Objektivi Strategjik	Veprimet e detajuara		Bashkia Kamëz, Këshilli Bashkiak		2025-2030
5.1.2		Rritje progresive e buxhetit vjetor operacional+mirëmbajtjes drejt mbulimit total të kostove operacionale dhe kostos kapitale;		Bashkia Kamëz		2025-2030
5.1.3		Kompesime financiare për konsumatorët me pamundësi për të paguar (me asistencë sociale apo me të ardhurave të ulëta) dhe jo për grumbullim inefficient të tarifave;		Bashkia Kamëz		2025-2030
5.1.4		Hartimi i projekteve konkrete dhe të kërkohet mbështetje financiare për investimet e mëdha nga fondet e qeverisë, donatorë, hua nga institucione financiare apo banka;		Bashkia Shkodër, Këshilli Bashkiak		2025-2030
5.1.5		Rifreskimi i bazës së të dhënave të konsumatorëve duke synuar rritjen e numrit të tarifë paguesve drejt mbulimit total;		Bashkia Kamëz Këshilli Bashkiak		2025-2030
5.1.7		Aplikimi i penaliteve të qarta efektive, dhe procedurave detyruese për mos pagimin e tarifave të mbetjeve;		Bashkia Kamëz		2025-2030
5.1.8		Vendos stimuj për minimizimin, riciklimin dhe kompostimin e mbetjeve: Aplikimi i uljeve në tarifat dhe heqja e tyre për konsumatorët e përfshirë në programet pilot të minimizimit;		Bashkia Kamëz		2025-2030
5.1.9		Rishikimi dhe përmirësimi i tarifimit të bizneseve, në përputhje të plotë me parimin "ndotësi paguan";		Bashkia Kamëz, Këshilli Bashkiak		2025-2030

8.6 Komponenti: Ndërgjegjësimi Publik dhe Edukimi

6	Objektivi Strategjik	Veprimet e detajuara	Roli drejtues dhe Partnerët e tjerë	Afatet kohore
6.1	Sensibilizimi i komunitetit dhe bizneseve për t'u bërë pjesë e iniciativave të bashkisë për mbajtjen pastër të territorit, pagimin e tarifës së pastrimit, si dhe për aplikimin e skemave inovative për minimizimin e mbetjeve			
6.1.1		Ofrimi i vazhdueshëm i informacioneve të përgjithshme për publikun dhe bizneset; broshura informative, buletinë, postera, rrjete sociale, etj;	Ndërmarrja e Pastrimit ; Konsulentë & Ekspertë të jashtëm të komunitetit, Bizneset e riciklimit, OJQ-të.	2025-2030
6.1.2		Ofrimi i informacioneve specifike për grupet e interesit (konsumatorët në zonat pilot);	Ndërmarrja e Pastrimit ; Konsulentë & Ekspertë të jashtëm të komunitetit, Bizneset e riciklimit, OJQ-të.	2025-2030
6.1.3		Laçimi i nismave të reja (grumbullimi individual i mbetjeve, riciklimi dhe kompostimi) duke përdorur promovimin në TV, radio lokale dhe gazeta;	Ndërmarrja e Pastrimit ; Bizneset e riciklimit, OJQ-të.	2025-2030
6.1.4		Krijimi i grupeve në komunitet për promovimin e edukimit dhe ndërgjegjësimin në zonat pilot dhe konsumatorët pilot;	Ndërmarrja e Pastrimit ; Konsulentë & Ekspertë të jashtëm të komunitetit, Bizneset e riciklimit, OJQ-të.	2025-2030
6.1.5		Hartimi dhe shpërndarja e paketave të informacionit sipas grupeve të interesit (qytetarët, bizneset, shkollat, industria, etj);	Ndërmarrja e Pastrimit ; Komuniteti, Bizneset e riciklimit, OJQ-të, Donatorë	2025-2030
6.1.6		Përdorimi i mjeteve teknologjike dhe kontenerierët për të ofruar informacion të përgjithshëm (slogan, numrat e kontaktit, grafikët e shërbimit);	Ndërmarrja e Pastrimit	2025-2030
6.1.7		Realizimi i fushatës "derë më derë" për të përfshirë popullatën dhe bizneset në mënyrë eficiente mbi aktivitetet e riciklimit dhe ndarjes në burim dhe pagesës së tarifës së pastrimit;	Ndërmarrja e Pastrimit ; Bizneset e riciklimit, Vullnetarë, OJQ-të,	2025-2030
6.1.8		Hartimi i programeve dhe fushatave "vijuese" të riciklimit për të përmirësuar cilësinë e ndarjes në burim përmes programeve të riciklimit;	Ndërmarrja e Pastrimit ; Konsulentë & Ekspertë të jashtëm, Bizneset e riciklimit, Vullnetarë, OJQ-të.	2025-2030
6.1.9		Hartimi dhe shpërndarja e udhëzuesve dhe ilustrimeve për riciklimin dhe kompostimin, për shkollat, bizneset, banorët.	Ndërmarrja e Pastrimit ; Konsulentë & Ekspertë të jashtëm të komunitetit, Bizneset e riciklimit, OJQ-të.	2025-2030

10 Monitorimi

Ky plan duhet të parashikojë hapat në vazhdim, indikatorët dhe mjetet për të vlerësuar punën e bërë, për të verifikuar nëse objektivat janë përmbushur dhe të raportimin tek vendimmarrësit. Qëllimi është që të sigurojë që autoritetet përgjegjëse u është dhënë mundësia për të ndjekur zhvillimin dhe zbatimin e planit dhe të vendosin mbi masat shtesë, nëse është e nevojshme. Studimi bazë, i kryer për qëllim të këtij plani, do të shërbejë si një status bazë mbi të cilën do të vlerësohen arritjet e objektivave dhe targeteve dhe mbi të cilat do të matet ndryshimi i indikatorëve të performancës së planit.

Monitorimi i planit duhet të jetë një proces i vazhdueshëm me vlerësime periodike dhe, nëse është e nevojshme mund të kërkojë rishikimin e objektivave dhe masave të planit. Monitorimi i planit do të shërbejë për:

- Për të dhënë informacion të vazhdueshëm tek bashkëpunëtorët dhe grupet e interesit, mbi statusin e zbatimit të planit;
- Për të analizuar statusin dhe për të vlerësuar efektivitetin e skemave të zbatuara;
- Për të përshtatur, modifikuar ose forcuar skemat apo programet në proces, ose për të krijuar të reja më të përshtatshme apo të efektshme;
- Për të mësuar, përditësuar dhe shpërndarë informacion dhe njohuri.

10.1 Si kryhet monitorimi dhe vlerësimi

Bashkia duhet të ndjekë këto hapa në kryerjen e procesit të monitorimit dhe të vlerësimit të planit, si më poshtë:

- 1) Rishikimi i situatës: Rishikimi i objektivave dhe synimeve, kontrolli nëse ato i përshtaten kontekstit real dhe vlerësimi i tyre me anë të indikatorëve;
- 2) Mbledhja e evidencave sasiore dhe cilësore që lidhen me mbetjet;
- 3) Analizimi i evidencave: Analizimi i të dhënave për të matur progresin, krahasimi i rezultateve me objektivat dhe synimet, kontrolli nëse objektivat janë arritur në një afat kohor të dëshiruar;
- 4) Dokumentimi i konkluzioneve
- 5) Ndarja dhe diskutimi i konkluzioneve: Gjetjet duhet të ndahen me palët e interesuara dhe domosdoshmërisht me vendimmarrësit.

